



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA E SUHAREKËS
OPSTINE SUVA REKA
THE MUNICIPALITY OF SUHAREKA



30.12.2025

REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA E SUHAREKËS REPUBLIKA KOSOVA - OPSTINA SUVA REKA REPUBLIC OF KOSOVA - THE MUNICIPALITY OF SUHAREKA			
MARRE NË DOREZIM-PRIMLJENO-RECEIVED			
Njësia org. Org. Jedinica Org. Unit	Numri Broj Number	Shtojca Prilog Appendix	Vlera Vrednost Value
01	052	78180	7

RAPORTI I PUNËS SË KRYETARIT JANAR-DHJETOR 2025

BALI MUHARREMAJ

Email [bali.muharremaj@rks-gov.net]

HYRJE

Ky raport paraqet një pasqyrë të detajuar të punës dhe angazhimeve të Kryetarit të Komunës së Suharekës, z. Bali Muharremaj, drejtorive komunale dhe sektorëve përkatës, për periudhën janar – dhjetor 2025. Raporti është hartuar me qëllim të informimit të plotë dhe transparent të qytetarëve të Komunës së Suharekës, institucioneve qendrore, partnerëve vendorë dhe ndërkombëtarë, si dhe të gjitha palëve të interesuara, mbi aktivitetet, projektet dhe rezultatet e arritura gjatë këtij viti.

Gjatë vitit 2025, Komuna e Suharekës, nën udhëheqjen e Kryetarit z. Bali Muharremaj, ka vazhduar të ushtrojë me përgjegjësi të plotë kompetencat ligjore dhe institucionale, duke zbatuar politika zhvillimore të orientuara drejt përmirësimit të cilësisë së jetës së qytetarëve. Angazhimi institucional është fokusuar në zhvillimin ekonomik lokal, investimet në infrastrukturë, avancimin e shërbimeve publike, si dhe në mbështetjen e sektorëve të rëndësishëm si arsimi, kultura, sporti dhe mirëqenia sociale.

Komuna e Suharekës ka qenë gjithmonë transparente dhe e hapur ndaj qytetarëve, duke garantuar qasje të lirë në informata publike, publikimin e rregullt të vendimeve dhe dokumenteve zyrtare, si dhe përfshirjen e qytetarëve në proceset vendimmarrëse përmes takimeve publike dhe konsultimeve të vazhdueshme. Transparenca, llogaridhënia dhe përgjegjshmëria kanë qenë parime themelore në punën e Kryetarit z. Bali Muharremaj, drejtorive komunale dhe sektorëve përkatës.

Ky raport pasqyron punën e përbashkët dhe bashkëpunimin e vazhdueshëm ndërmjet Kryetarit të Komunës, drejtorive komunale dhe sektorëve, duke evidentuar projektet e realizuara, shërbimet e ofruara dhe rezultatet konkrete të arritura gjatë vitit 2025, si dhe sfidat e hasura gjatë zbatimit të planeve dhe politikave komunale. Po ashtu, raporti reflekton përkushtimin institucional për menaxhim të përgjegjshëm dhe transparent të burimeve publike, si dhe përdorim efikas të buxhetit të Komunës së Suharekës.

Raporti i punës për periudhën janar – dhjetor 2025 synon të shërbejë si dokument informues dhe orientues për qytetarët dhe institucionet, si dhe si bazë për planifikimin e veprimeve dhe projekteve të ardhshme. Përmes këtij raporti, Komuna e Suharekës dëshmon angazhimin e saj të vazhdueshëm për qeverisje të mirë, transparente dhe gjithëpërfshirëse, në shërbim të interesit publik dhe zhvillimit të qëndrueshëm të komunës.

PËRMBAJTJA

1.DREJTORIA PËR EKONOMI BUXHET DHE FINANCA

2.DREJTORIA PËR SHËRBIME PUBLIKE DHE EMERGJENC

3.DREJTORIA PËR INSPEKSION

4.DREJTORIA PËR KULTURË RINI SPORT DHE MËRGATË

5.DREJTORIA PËR URBANIZËM PLANIFIKIM DHE MJEDIS

6.DREJTORIA PËR ARSIM

7.DREJTORIA PËR SHËRBIME PRONSORE ,JURIDIKE DHE KADASTER

8.DREJTORIA PËR SHËNDETËSI DHE MIRËQENIESOCIALE

9.DREJTORIA PËR BUJQËSI ZHVILLIM RURAL DHE PYLLTARI

10.DREJTORIA PËR ADMINISTRATË

DREJTORIA PËR EKONOMI BUXHET DHE FINANCA

Sektori për Ekonomi, Financa dhe Buxhet:

- Janë faturuar **3227** biznese me vlerë prej: **645,275.25 €**.
- Gjithashtu janë faturuar **140** shfrytëzues të pronës komunale në vlerë prej: **178,371.80€**.
- Gjatë kësaj periudhe janë aprovuar **221** kërkesa dhe vendime për zbritje të Taksës në Aktivitet ku vlera e zbritur është: **89,664.92 €**.
- Të hyrat nga Taksa në Aktivitet deri më 26.12.2025 janë: **105,993.29 €** ndërsa të hyrat nga Renta dhe Qeraja janë: **136,872.44 €**.
- Gjatë kësaj periudhe janë lëshuar **18,406** fletëpagesa për regjistrim të automjeteve, prej të cilave **437** fletëpagesa janë të liruara ndërsa vlera totale e pagesave është: **188,354.00€**.
- Janë lëshuar **487** vërtetime dhe **15** çertifikata të ndryshme nga zyrtarët për shërbime të qytetarëve.
- Ne Qendrën e regjistrimit të biznesit deri me datë 26.12.2025 janë regjistruar **290** biznese, prej të cilave **93** janë biznese Individuale, **196** janë SH.P.K. dhe **1** është Shoqëri Aksionare.
- Në këtë periudhë janë shuar **45** biznese si dhe janë realizuar **210** modifikime.

Zyra për Regjistrimin e Pasurisë:

- Totali i regjistrimit të pasurive kapitale deri me datë 26.12.2025 është **356,460,317.43 €**, ndërsa i pasurive jo kapitale (vlera nën 1,000.00 €) është **3,207,882.91 €**.

Zyra e Thesarit:

- Nga fillimi i vitit deri më 26.12.2025 janë Çertifikuar dhe Aprovuar **6081** lëndë dhe **12,046,983.50 €** pagesa nga të gjitha programet e Komunës së Suharekës.
- Të gjitha këto pagesa, pas Çertifikimit dhe Aprovimit janë sistemuar në **98** regjistrator dhe janë arkivuar në Arkivin Financiar të KK në Suharekë.

Sektori i Tatimit në Pronë:

- Janë faturuar dhe dërguar te tatimpaguesit **13,493** fatura me vlerë mbi **1€**. Shuma totale e faturave për objekte dhe parcela është: **1,545,053.42 €**.
- Të hyrat nga Tatimi në Pronë (objekte dhe parcela) deri me 26.12.2025 janë: **784,678.75 €** nga **7349** tatimpagues.
- Sipas kërkesës së Ministrisë është duke u bërë rianketimi dhe vendosja e pikave të sakta të lokacionit për **2404** objekte të cilat kanë mbetur pa zonë të vlersimit.
- Gjithashtu janë lëshuar edhe **409** çertifikata për QPS.

- Gjatë kësaj periudhe janë shqyrtuar **301** ankesa dhe kërkesa të tatimpaguesve dhe **101** kërkesa të pa shqyrtuara për shkak të problemeve me sistem.
- Janë regjistruar **152** objekte të reja, **252** modifikime dhe **56** objekte janë paisur me fotografi.

Të hyrat vetanake të realizuara deri me datë: 26.12.2025

- Të hyrat nga Tatimi në Pronë:----- 784,678.75 €
- Të hyrat nga Taksa në Aktivitet:----- 105,993.29 €
- Të hyrat nga Renta dhe Qeraja:----- 136,872.44 €
- Të hyrat nga taksa e regjistrimit të automjeteve:----- 188,354.00 €

Emërtimi i Të Hyrave	Buxheti i Alokuar	Buxheti i Shpenzuar	%
Paga & Shtesa:	11,548,871.30 €	11,550,077.12 €	100.01%
Mallra & Shërbime:	3,457,949.69 €	3,402,719.16 €	98.40%
Shpenzime Komunale:	616,713.04 €	579,028.18 €	93.89%
Subvencione & Transfere:	1,225,212.25 €	1,223,844.03 €	99.89%
Investime Kapitale:	7,555,513.53 €	6,793,153.41 €	89.91%
Totali:	24,404,259.81 €	23,548,821.90 €	96.49%

2.DREJTORIA PËR SHËRBIME PUBLIKE DHE EMERGJENCË

Sektori i Shërbimeve publike

Gjatë këtij viti të 2025-ës, në DSHPE –në Sektorin e Shërbime Publike janë kryer punë të ndryshme që kanë të bëjnë me natyrën e punës së kësaj Drejtorie. Disa nga punët më të rëndësishme në këtë drejtori ishin:

- Pranimi i faturave të shpenzimeve komunale,pranimi i faturave të mallrave dhe shërbimeve, si dhe pranimi i shumë fatura tjera në kuadër të Drejtorisë, po ashtu kryerja dhe përgaditja e faturave për pagesat e shpenzimeve komunale të Rrymës,Ujit,Telefonit, Mbeturinave.

- Po ashtu kryerja dhe përgaditja e faturave për pagesat të ndryshme për mallra dhe shërbime brenda sektorit të Shërbimeve Publike dhe Emergjencë.

- Kryerja e pagesave për punëtoreset e zjarrëfikësive dhe faturave të ndryshme për këtë sektor.

- Inicimi i procedurave minimale me zyrën e Prokurimit, për nevojat e zjarrëfikësive në kuadër të –DSHPE.

- Kontakte të shpeshta telefonike me Keds-in,Hidroregjionin,Ecoregjionin,PTK-në etj,për nevojat e Komunës, të qytetarëve për zgjidhjen e kërkesave të tyre për mes telefonit.

- Caktimi nëpër komisione të ndryshme për nëvojat e komunës.

- Përgaditja e kërkesave të KEDS-it, si dhe qytetarëve për pëlqimet konkrete të tyre.

- Realizimi i vizitave në teren për kërkesa të ndryshme (strehim, kanalizim, ujësjellës dhe infrastrukturë),por gjithmonë me urdhër të Drejtorit të Drejtorisë së Shërbimeve,Publike dhe Emergjencë.

- Lëshimi i dokumenteve për persona fizikë dhe institucione,

- Përgaditja e planifikimit të buxhetit sipas kërkesave për Drejtorinë e Shërbimeve Publike dhe Emergjencë, sipas kërkesës së Zyrtarit Kryesor financiar etj.

- Raportimi i raporteve mujore për qdo muaj për faturat e paguara dhe të papaguara, për zyrtarin Kryesor Financiar të Drejtorisë së Financave.

- Kërkesa të shpeshta për ndryshime të faturave nga operatorët e ndryshëm, në bazë të kërkesës të cilën e bëjmë ne si Drejtori e Shërbimeve Publike dhe Emergjencë.

-Takime - konsultime të shpeshta me qytetar, për kërkesat dhe nevojat e tyre .

-Takime-konsultime të shpeshta mes bashkëpunëtorëve dhe Drejtorit për punët e ndryshme në Drejtori.

-Raportime të shpeshta Drejtorit, për shpenzimet e sektorit të zjarrëfiksive, për mirëmbajtjen e veturave, sigurimin e automjeteve, shpenzimet e naftës, si dhe shumë shpenzime tjera të sektorit të zjarrfikësive.

-Takime dhe kontakte të shpeshta me zyrtarin kryesor finaciari-ZKF për nevojat e Drejtorisë.

- Bashkëpunim të ndërsjellë me të gjitha sektorët e Drejtorive e në veqanti me Drejtorinë e Urbanizmit, me Zyrën e Prokurimit, me Drejtorinë e Arsimit (DKA), me Drejtorinë e Administratës, Drejtorinë e Katastrit e tjera), pastaj me “Hidro-regjionin Jugor” njësia Suharekë “ Eko-regjionin “ njësia Suharekë , EKO-THERANDA, KEDS-in , PTK-në etj.

-Deri me tash kanë ardhur në drejtorinë kërkesa të ndryshme si në vijim:

1) **Gjatë muajit Janar**, kemi pranuar 11 Lënda, ku 8 lëndë janë refuzuar, 3 janë miratuar

2) **Gjatë muajit Shkurt**, kemi pranuar 15 Lënda, ku 6 lëndë janë refuzuar, 7 janë miratuar, 2 janë në procedurë për vizitë.

3) **Gjatë muajit Mars**, kemi pranuar 22 Lënda, ku 3 lëndë janë refuzuar, 9 janë miratuar dhe 10 janë në proces.

4) **Gjatë muajit Prill**, kemi pranuar 49 Lënda, ku 8 lëndë janë refuzuar, 41 janë miratuar

5) **Gjatë muajit Maj**, kemi pranuar 28 Lënda, ku 16 lëndë janë refuzuar, 10 janë miratuar dhe 2 janë në proces

6) **Gjatë muajit Qershor**, kemi pranuar 23 Lënda, ku 6 lëndë janë refuzuar, 11 janë miratuar, dhe 6 janë në proces.

7) **Gjatë muajit Korrik**, kemi pranuar 49 Lënda, ku 30 lëndë janë refuzuar, 17 janë miratuar, dhe 2 janë në aktpërcjellës në drejtorinë tjetra

8) **Gjatë muajit Gusht**, kemi pranuar 26 Lënda, ku 8 lëndë janë refuzuar, 13 janë miratuar, dhe 5 janë në aktpërcjellës në drejtorinë tjetra.

9) **Gjatë muajit Shtator**, kemi pranuar 21 Lënda, ku 10 lëndë janë refuzuar, 11 janë miratuar,

10) **Gjatë muajit Tetor**, kemi pranuar 5 Lënda, ku 4 lëndë janë refuzuar, 11 janë miratuar,

11) **Gjatë muajit Nëntor**, kemi pranuar 23 Lënda, ku 12 lëndë janë refuzuar, 5 janë miratuar, dhe 6 janë në proces.

12) **Gjatë muajit Dhjetor**, kemi pranuar 7 Lënda, , 1 janë miratuar, dhe 6 janë në proces

Mirëmbajtja dhe pastrimi i rrugëve dhe trotuarëve (kontrat e vjetër Janar-Qershor 2025)

- Rrugët dhe trotuarët 169.76 km’
- Hapsirat publike (Parqet, sheshet, varrezat) 471435.38 m2
- Mirëmbajtja dhe pastrimi i qytetit (Kontrata e re Qershor-Dhjetor 2025)

Pastrimi i rrugëve lokale, 123,786 m’

Larja e rrugëve lokale dhe trotuarëve duke bërë larjen e tyre nga mbeturinat, 86,987.13 m’

Mirëmbajtja dhe pastrimi i shesheve, parqeve, shtigjeve të ecjes dhe lapidarëve, 75,675 m2

Pastrimi dhe mirëmbajtja e gjelbrimit në varreza, 186,666.68 m2

Mirëmbajtja e gjelbrimit në parqe, sheshe, shtigje të ecjes dhe përgjatë brezit rrugor, 173,172 m2

Ujitja e hapsirave te gjelbrimit, luleve dhe drunjeve dekorativ ne te gjitha hapsirat publike, 15,567.50 m2

Mirembajtja dhe pastrimi i shtratit te lumit ne zonen urbane, 2000 m'

Mirembajtja dhe pastrimi i hapsirave publike (te perbashketa) ne objektet shume banesore 32 cope(gjdo muaj që mirëmbahen 192).

Largimi I mbeturinave shtazore, 211 copë.

Mirëmbajtja dhe pastrimi i rrugëve lokale nga Bora me 153 km', sipas nevojës.

Pra gjithsej me dy kontrata janë pastruar dhe larë rrugë, trotuare 169.76+210.73=380.53 km'

Mirëmbajtja dimërore e rrugëve lokale, nga ky projekt deri me tani kemi pasur disa intervenime, ku pjesa dermuese e kesaj kontrate ka qenë me kujdestari.

Mirëmbajtja dhe pastrimi i rrugëve lokale nga Bora me 153 km', sipas nevojës cdo rrugë është pastruar.

-Inspektori I preventives së Zjarrit

Lënda: Raport i punës për periudhën Janar-Dhjetor 2025

Në periudhen kohore Janar-Djetor 2025 në sektorin e parandalimit të zjarrit janë kryer punë të fushës së parandalimit të zjarrit duke u bazuar në Planin e punës të paraparë për vitin 2025,si dhe punë tjera të cilat i kemi hasur në teren.

Në këtë vit kemi bërë inspektime të objekteve prodhuese të cilat kanë paraqitë rrezik të lartë për zjarr si Depozita e gasit Shala Gas ne Shiroke, dy fabrikat e prodhimit te stiroporit, fabrika e kepuçëve SOLID, disa qendra tregtare, e objekte tjera te rendesishme. Përgjithësisht mund të konstatojmë se në shumicën e këtyre objekteve të inspektuara, i kanë zbatuar vërejtjet e dhanuna në parandalimin e zjarrit.

Poashtu në kuadër te parandalimit dhe rreziqeve nga zjarri në objektet e larta banesore, kemi inspektuar disa objekte me etazhitet të lartë ku vërehen shumë mangësi në vendosjen e hidrantëve për fikjen e zjarrit, duke filluar nga bodrumet e ndërtesave që njëherit shërbejne edhe si garazha të cilat në shumë prej objekteve mungojnë.Këto objekte edhe pas shumë viteve nuk kanë pranim teknik dhe në vazhdimësi paraqesin rrezik për jetën e qytetarëve.

Gjatë këtij viti kemi pasë një numër bukur të madh të zjarreve duke filluar prej atyre fushore, të shtëpive të banimit , ku kemi dalë në vendin e ngjarjes me policë hetues në identifikimin e shkaqeve të shpërthimit të zjarreve.

Gjithmonë gjatë punës në teren, me anë të inspektimeve,kemi për qëllim ngritjen e vetëdijes qytetare mbi rreziqet që vijnë nga zjarret,dëmet që shkaktohen nga zjarret,dhe pasojat që shkaktohen në humbjen e pasurisë dhe jetës së njerëzve.

Më poshtë do të eidentoj punët të cilat janë kryer në periudhën kohore Janar-Dhjetor 2025 duke u bazuar në Planin vjetor të punës.

1.Inspektime të rregullta.....	40
2.Inspektime fillestare të objekteve.....	3
3.Në sektorin Publik.....	1
4.Në sektorin privat.....	39
5.Inspektime kontrolluese.....	26
6.Masa të shqiptuara.....	154
7.Dalje në vendngjarje me rastin e zjarreve.....	12
8.Raport, përkeqësim i motit nga erëra të fuqishme.....	5
10.Vërtetime.....	11
11.Shkresa për drejtoritë komunale dhe institucionet tjera.....	14
12.Shpërndarje e Apelit nëpër fshatra,mbi masat e shtuara të mbrojtjes nga zjarri gjatë sezonit të veres.....	1

-Sektori për infrastrukturë-

Gjatë periudhës Janar-Dhjetor 2025, sipas procedurave ligjore janë përgatitur dokumentacionet për Projektet Kapitale për vitin fiskal 2025. Janë bërë fillimisht sistematizimi i dokumentacionit të vitit paraprak të projekteve, përgatitje të dokumentacioneve si dhe kërkesa dhe Deklarata e Nevojave dhe Përcaktimit të Disponueshmërisë së

fondeve për inicim të procedurave, zotimi i mjeteve si dhe hartimi i projekteve për projektet kapitale të vitit fiskal 2025 dhe atë:

Projektet të cilat janë të kontraktuara në vitin: 2024 të cilat janë kontrata shumëvjeqare janë menaxhuar nga Drejtoria e Sherbimeve Publike dhe Emergjencë dhe punimet janë ndërprerë për shkak të kushteve atmosferike dhe pas krijimit të kushteve atmosferike, punimet kanë vazhduar edhe në vitin 2025.

Si dhe është bërë menaxhimi i projekteve të cilat janë: Projekte me Bashkëfinancim me Ministrinë e Infrastrukturës.

Projektet të cilan janë inicuar dhe kontratat e nënshkruara janë si në vijim:

Tabela 4.2. 624 - Suharekë KAB- për Projektet Kapitale 2025-2027										
		Vlera e Kontrates	OE	Asfaltit	Kubëza	Kanalizim	Ndiqim	Trotuar	Hapesira publike	Sanimi I rrugeve
	Emri i Projektit									
Vendbanime	TOTALI I SHPENZIMEVE KAPITALE 2025-2027									
18012	Shërbimet Publike dhe Emergjencë			m²	m²	m'	m'	m²	m²	m²
Bllacë	Ndërtimi i rrugëve lokale "Mehmet Lumi"-degëzim,"Martiret e Sukave"-degëzim, "Uniteti" ,Selim Ali Baku", "Alush Rexhepi"-degëzim,"Shkodra", "Ramadan Suka"-vazhdim,"Shtabi Ushtarak"-degëzim,"Valbona"-vazhdim "Kadri Qollaku"-degëzim dhe "Trimat"-degëzim në Bllacë .	73,457.25	Seticom merc SH.P.K.		4,164.00					
Breshan	Ndërtimi i rrugës "Te Varrezat-Parajsa" në Breshan .	8,586.50	Seticom merc SH.P.K.		186.14					
Budakove	Ndërtimi i rrugëve lokale "Furra e UÇK-së", "Ali Buqa" e "Sherif Buqa" në Budakovë .	47,476.43	VALI SH.P.K		2,471.00					
Bukosh	Ndërtimi i rrugëve lokale "Zylfije Sopa" dhe "Qamil Kadolli" në Bukosh.	31,396.95	Seticom merc SH.P.K.		1,487.00					
Delloç	Ndërtimi i rrugës lokale "Burimi i fshatit" në Delloç .	9,853.90	GEB SH.P.K	672.00						
Doberdelan	Ndërtimi i rrugëve lokale "Izet Shefketi" dhe "Bajram Islami" në Doberdelan.	26,773.00	Kab Holding SH.P.K.	1,300.00						
Dubravë	Ndërtimi i rrugëve lokale "Jetish Limani"-vazhdim,"Haxhi Gashi"-segment,dhe "Kadri Ramadani" segment në Dubravë .	28,218.90	GASHI 3 ING SH.P.K.		1,479.16					
Duhel	Ndërtimi i rrugëve lokale "Sherif Çatani", "Haxhi Bujari" "Kukësi"-aneks dhe "Shotë Galica" në Duhel.	29,955.00	THERACOM SH.P.K.		1,801.01					
Dvoran	Ndërtimi i rrugës lokale "Qamët"-vazhdim në Dvoran .	8,345.00	THERACOM SH.P.K.		374.00					
Gelancë	Ndërtimi i rrugëve lokale "Sherif Qadraku",-segment dhe "Gani Kukaj" në Gelancë .	14,961.40	GEB SH.P.K	470.17	460.00					
Gjinoc	Ndërtimi i rrugëve lokale "Behlulaj ", "Ali Jupaj", "Mbreti	51,997.00	FLO-CO SH.P.K.	945.00						

	Agron"-segment,"Lushnja"-segment "Theranda"-segment në Gjinoc.									
Grejko c	Ndërtimi i rrugëve lokale "Rahim Salihu", "Jemin Jashari", "e Safet Kica"-degëzim në Grejko c.	44,550.00	H.SEFERI SH.P.K.	200.00	190.00					
Grejqevc	Ndërtimi i rrugëve lokale "Bashkimi" dhe "Esat Qarri" në Grejqevc.	31,775.00	FLO-CO SH.P.K.	1,990.00						
Javor	Ndërtimi i rrugës lokale "Ali Zogaj" në Javor	18,910.00	GEB SH.P.K	900.00						
Kaster c	Rikonstruimi i rrugës kryesore në Kasterc.			60.50	232.52					
Krushice e eperm e	Ndërtimi i rrugës lokale "Shtabi i UÇK-së" faza e parë në Krushicë e Eperme.	12,678.66	Xhevat Kokollar i B.I		721.79					
Krushice e poshtme	Ndërtimi i rrugës "Iagjia e Gashëve" në Krushicë e Poshtme.	8,885.72	GEB SH.P.K		340.04					
Leshan	Ndërtimi i rrugëve lokale "Bashkim Kabashi" Ismet Kodra"-degëzim dhe "Dituria" në Leshan.	27,415.40	H.SEFERI SH.P.K.		1,553.39					
Luzhnice	Ndërtimi i rrugës lokale "Afrim Buqaj"-segment në Luzhnicë.	8,470.50	HYSNI H.SUKA B>I		380.00					
Maqiteve	Ndërtimi i rrugës kryesore "Hamzë Jashari" në Maqitevë.	79,429.12	Kab Holding SH.P.K.	5,264.00						
Mohlan	Ndërtimi i trotuarit në rrugën "Florim Gashi" e " Qamil Gashi", në Mohlan.	9,291.00	VALI SH.P.K					405.6		
Mushtishti	Ndërtimi i rrugëve lokale "Ushtari I UÇK-ës "-Aneks,"Qamil Mushtishti",-aneks","Bafti Shala"- 2 anekse "Isak Shala" dhe "Rugova"-aneks në Mushtisht.	78,807.50	H.SEFERI SH.P.K.	3,670.00						
Neperbisht	Ndërtimi i rrugës lokale e "Varrezave" në Neperbisht.	18,675.20	FLORI SH.P.K.		918.575					
Nishor	Ndërtimi i rrugëve lokale "Shaqir Xheladini", "Ramiz Ajeti",-segment,"Imer Bytyqi"-segment,rruga e vorrezave në lagjen "Kadriajaj","Brinjët e Isarit"-vazhdim,"Rasim Ramadani","Demaj"-vazhdim,"Tahir Ademi" dhe Rasim Emrushin në Nishor.	48,059.85	GASHI 3 ING SH.P.K.		2,296.00					
Papaz	Ndërtimi i rrugës lokale "Kroni i Nikës" në Papaz.	9,304.68	BVL KO, ART PROJECT SH.P.K.		525.00					
Peqan	Ndërtimi i rrugëve lokale "Ilir Konushevc"-segment djathtas,"Ahmet Sefa",Emona", "Muhamet Krasniqi" "Jashar Shasivar Bytyqi" në Peqan.	33,214.50	THERAC OM SH.P.K.		1,891.28					
Popolan	Ndërtimi i rrugës lokale "Shaip Kolgeci" në Popolan.	9,331.00	GASHI 3 ING SH.P.K.		462.32					
Qadrank	Ndërtimi i rrugës lokale "Mehmet Tafolli" faza e parë në Qadrank.	19,717.75	BVL KO, ART PROJECT SH.P.K.	1,200.00						
Reqan	Ndërtimi i rrugës lokale "Te lapidari" në Reqan.	24,277.48	GASHI 3 ING SH.P.K.		1,526.31					
Reshtan	Ndërtimi i rrugës lokale "Kadri Morina" në Reshtan.	18,078.60	N.N.P "Hysnia"	464.34	374.27					

Komu në	Instalimi dhe sanimi i ndriqimeve publike në Samadraxhë,Studenqan,Reshtan,Semetisht,Mushtisht,Budakovë, Reqan dhe qytet.									
Komu në	Ndërtimi dhe rikonstruimi i kanalizimeve në Neprebisht,Grejkoc,Bllacë,Mushtisht dhe Komunë" Suharekë .	462,572.55	ERST BAU SH.P.K			7716. 274	PA RAPO RTIN PERF UNDI MTA R			
Komu në	Ndertimi i shtreterve të lumit "Toplluha"dhe rikonstruimi tyre.									
Komu në	Ndertimi i zonave te gjelbruara dhe rekreative në Vraniq,Mushtisht,Studenqan e fshatra tjera dhe Suharekë.	28,970.55	N.P.SH. "Osmani"						1,750.00	
Komu në	Ndërtimi i urave në lumin "Toplluha",Grejkoc ,Mushtisht dhe Komunë.									
Komu në	Regullimi dhe rikonsturimi i lumit "Toplluha" në Suharekë .									
Qytet SUHAREKE	Ndertimi dhe rikonstruimi i rrugeve lokale "Muhlan-Krushicë, Papaz,Budakovë Buzhalë, Studenqan, Topliqan,Terrnje.Gelanc dhe në Komunë		three Group SH.P.K. N.P.T Bamirs	1,459.00	943.50					2,402.50
Qytet SUHAREKE	Ndertimi dhe rikonstruimi i rrugeve lokale "Milit Kryeziu", "Xhavit Bajraktari",Adem Kuqi","Zekë Bajraktari","Luigj Nikolla"-segment dhe "Aleksander Moisiu" në Suharekë .	133,491.76	Kab Holding SH.P.K.	5,778.00	1,603.00					
Qytet SUHAREKE	Ndërtimi dhe rregullimi i varrezve në Biraq .									
Sallagrazhdë	Ndërtimi i rrugës lokale "Mikel Nika"në Sallagrazhdë .	31,400.00	THERAC OM SH.P.K.	316						
Samadraxhë	Ndërtimi i rrugës "Gjallica","Feim Morina"-segment,"5 Nëntori"-segment,dhe "Nexhmedin Hoti"-segment në Samadraxhë .	66,929.50	THERAC OM SH.P.K.		3,833.13					
Savrovë	Ndërtimi i rrugë lokale - Rruga UÇK-së -vazhdim në Savrovë .	19,145.53	GASHI 3 ING SH.P.K.		929.66					
Semetisht	Ndërtimi i rrugëve lokale "Ukë Bytyqi"-degëzim te shkolla dhe "Spitali I Luftës" në Semetisht .	47,086.33	FLO-CO SH.P.K.	495.00	1,996.02					
Sopijë	Ndërtimi i rrugëve lokale "Muharrem Balija"(Albert Mazreku)- segment,"Naum Vexhelharxhi"-segment "2 Prilli"(Ahmet Sadikaj)-segment "Salih Azizi"në Sopijë .	49,894.3 +4,989.25	FLO-CO SH.P.K.	699.00	2,362.15					
Studençan	Ndërtimi i rrugëve lokale"Eqerem Qabej","Arsim Gegaj" dhe "Gurra" në Studençan .	76,737.50	FLORI SH.P.K.		3,377.00					
Sllapuzhan	Ndërtimi i rrugës"Komandant Xhavit" -segment dhe "Xhemajl Basha"-segment në Sllapuzhan .	18,327.94	Ermal Sylaj B.I.	1,013.08						
Shirokë	Ndërtimi i rrugëve lokale"Hil Mosi",dhe "Tafolli" në	23,646.35	VALI SH.P.K		1,134.99					

	Shirokë .									
Topliq an	Ndërtimi i rrugës "Te vorrezat"-faza e parë në Topliqan	15,600.50	CONEX L.L.C		180.00					
Tërrnj e	Ndërtimi i rrugës lokale "Dajti"-vzhdim në Tërrnje .	20,246.25	FLORI SH.P.K.							
Vraniq	Ndërtimi i rrugëve lokale "Firajes",dhe "Matoshve " në Vraniq .	46,635.00	THERAC OM SH.P.K.	957.00	1,454.00					
Dubra vë	Nërtimi i impiantit për ujra të zeza në Dubravë	249,882.00	K-ING SH.P.K							

PROJEKTET E FINANCUARA NGA MAPL DHE DEMOS ME BASHKËFINANCIM (GRANTI I PËRFORMANCËS)

Emri i projektit	Vlera kontrates	OE								
Ndertimi i objektit te NPL "Eko Theranda" SHA shirokë	€ 468,773.61	NexBuild L.L.C,VIA SH.P.K,F amis CO								
Ndertimi i rruges qe lidh fshatrat Dubrave-Savrove	€ 104,595.30	FLO-CO SH.P.K.	50 80. 01							
Ndertimi i rruges "Shkupi" qe lidh fshatrat Ternnje dhe Neperbisht	€ 128,128.00	Three Group SH.P.K. N.P.T Bamirs	37 39			740	865.29			
Asfaltimi i rrugeve "Garibaldi", "Adem Kuqi","Milit Kryeziu","Fadil Elshani","Vudro Vilson" dhe "Migjeni" ne Suharekë	€ 238,479.00	N.P.T. "Bamirs"	63 52			1050	2308			
Nderitmi i rruges qe lidh fshatrat "Shiroke-Sopi-Topliqan"										
Asfaltimi i rruges tek QMF dhe nenstacioni i policise,zjarrfikesve ne fshatin ne fshatin Studenqan	€ 29,105.50	Vehbi Mamaj B.I	14 71							

Ndertimi i rruges "Luigj Nikolla" segment ne Suhareke	€ 23,764.00	Kab Holding SH.P.K.	11 16						
Ndertimi i rruges qe lidh fshatrat Samadrexhë-Dobërdelan	€ 53,755.40	N.N.T Etniku	20 34						

Rikapitulim		
1	Asfalt (m²)	47,645.10
2	Kubëza (m²)	41,647.26
3	Kanalizim (m)	7,716.27
4	Ndriqim (m)	1,790.00
5	Trotuar (m²)	3,578.89
6	Hapesira Publike (m²)	1,750.00
7	Sanimi I rrugeve (m²)	2,402.50

-Sektori për Emergjencë

Raporti vjetori NJPZSH për vitin 2025

Raport i intervenimeve 01.01.2025 - 26.12.2025

Realizimi i numrit të përgjithshëm të interven, struktura e zjarreve dhe int.tjera Janar-Dhjetor 2025													
2025	Nr.i përgj. i daljeve	Nr.i zjarrev e	Nr. i Teknik e	Nr.i shërbimev e	Aksident e rrugore	Vërshim e	Të rejs h	Të lënduar			Të vdekur		
								zj .	qyt .	to t	zj .	qyt .	to t
Janar	22	16	4	0	1	0	1	0	4	4	0	0	0
Shkurt	16	11	0	3	2	0	0	0	3	3	0	1	1
Mars	29	24	0	4	0	0	1	0	0	0	0	0	0
Prill	25	11	5	7	1	0	0	0	2	2	0	0	0
Maj	23	14	2	3	3	0	0	0	4	4	0	3	3
Qershor	32	28	0	4	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Korrik	90	80	6	2	0	0	2	0	0	0	0	0	0
Gusht	80	65	6	6	1	0	2	0	4	4	0	0	0
Shtator	60	43	4	10	3	0	0	0	8	8	0	1	1
Tetor	17	9	5	1	0	1	1	0	1	1	0	0	0
Nëntor	13	4	2	0	3	4	0	0	1	1	0	1	1
Dhjetor	14	10	0	2	2	0	0	0	4	4	0	1	1
Gjithsejt ë	421	315	34	42	16	5	7	0	31	31	0	7	7

3.DREJTORIA PËR INSPEKSION

Ky raport paraqet punën e Drejtorisë për Inspeksion në periudhën dymbëdhjetë mujore (Janar - Dhjetor, 2025). Raporti paraqet aktivitetet dhe punën e Drejtorisë, sipas fushave të rregulluara me ligje, akte nënligjore, vendime dhe urdhëresa në fuqi.

Drejtoria për Inspeksion do të jetë përgjegjëse për këto detyra:

1. Që të zbatohet ligjet dhe aktet tjera nënligjore si dhe Rregulloret e Kuvendit Komunal të Suharekës;
2. Inspektorët, sipas përgjegjësisë dhe kompetencave, kanë për qëllim përcjelljen, monitorimin dhe marrjen e masave, përmes vendimeve dhe konkluzioneve administrative, në funksion të mbikëqyrjes inspektuese, të fushave të rregulluara me ligje, akte nënligjore, vendime dhe urdhëresa në fuqi;
3. Ushtron kontrollimin dhe inspektimin e objekteve industriale, tregtare dhe depove të mallrave-produkteve për treg;
4. Bën përcjelljen e çmimeve të artikujve dhe shikimin e faturave të tregtisë me shumicë dhe pakicë;
5. Hulumtojnë, konstatojnë, evidentojnë, udhëzojnë, evitojnë, ekzekutojnë dhe ushtrojnë fletëparaqitje në gjykatë;
6. Inspektorati kujdeset që të zbatohet plani urbanistik, gjegjësisht inspekton lejet ndërtimore që lëshohen sipas dispozitave ligjore në fuqi;
7. Mbrojtja e konsumatorëve, gjegjësisht kujdesi për produktet ushqimore dhe joushqimore, të jenë në nivelin e duhur;
8. Mbrojtja e punëtorit në punë, mbrojtja dhe marrja e masave nga sëmundjet në: shëndetësi, bujqësi, ambient, komunikacion, shërbime publike, etj;
9. Koordinon aktivitetin dhe jep pëlqimin për veprimtarinë e transportit publik të udhëtarëve dhe mallrave, me kompanitë publike dhe shoqatat e taksistëve individual dhe operatorëve juridik sipas rregulloreve;
10. Bën mbikëqyrjen e mbrojtjes së ambientit në aspektin e mbeturinave, kanalizimit, ujit, shërbimeve tjera publike, për parandalimin e ndotjes dhe dëmtimin e ambientit.
11. Bën mbikëqyrjen e aktiviteteve të cilat shkaktojnë çrregullime të përgjithshme në ambient, materiet e rrezikshme dhe zonat e mbrojtura në natyrë duke identifikuar palën përgjegjëse.
12. Cakton linjat dhe rendin e udhëtimit për transportin publik të udhëtarëve; 18.2.12 Bashkëpunon me policinë për rregullimin e komunikacionit dhe ngritjen e sigurisë në komunikacion, në veçanti afër shkollave dhe institucioneve parashkollore;
13. Bën mbylljen e rrugëve për shfrytëzimin e tyre në raste të veçanta (festa shtetërore, punë të veçanta në interes të shtetit dhe komunës dhe punë të ngjashme);
14. Bënë kontrollin dhe inspektimin në lëmin e bujqësisë;
15. Kontrolli i hapësirave afariste, objekteve, pajisjet, prodhimin, qarkullimin dhe transportin e mallrave me origjinë bimore;

16. Merr masa për ruajtjen e shëndetit publikë dhe urdhëron tërheqjen e mallit të dyshimtë nga qarkullimi si dhe asgjësimin e tij;

17. Ushtron edhe kompetenca tjera që do t'i përcaktohen me ligj ose që delegohen nga pushteti qendror. Në kuadër të Drejtorisë së Inspeksionit përveç Drejtorit të Drejtorisë së Inspeksionit janë këto pozita:

Udhëheqes i Serktorit për Inspektime

Inspektori I tregut (2) dy Inspektor

Inspektori I ndërtimit (2) dy Inspektor

Inspektor të mjedisit dhe ambientit (3) tre Inspektor

Inspektori I komunikacionit

INSPEKTORI I AMBIENTIT

Gjatë kësaj periudhe, dymbëdhjetë mujore (Janar - Dhjetor, 2025), është përcjellur gjendja e përgjithshme e mjedisit në çështjet komunale në tërë territorin e Komunës së Suharekës, sipas planit përkatës, konform ligjit dhe rregulloreve në fuqi.

Inspektorët e ambientit I kanë kryer detyrat e punës në kompetenc sipas **Ligji Nr. 03/L-025** përmbrojtjen e mjedisit.

Gjithashtu është bërë shqyrtimi I të gjithave ankesave të qytetarëve që I përkasin lamiisë sone dhe është vepruar sipas rregullorëve përkatëse.

Gjithashtu kanë bashkëpunuar edhe me qytetarët dhe bizneset për zbatimin e dispozitave ligjore për të krijuar një ambient të pastër.

Kanë bërë kujdestari gjatë vikendeve dhe festave.

Është bere aktivitet në bashkëpunim me të gjitha institucionet relevante për pastrimin e hapësirave publike.

Pjesëmarrje në disa komisione të ndryshme, caktuar me aktvendime.

Gjatë kësaj periudhe, janë zhvilluar këto procedura:

• Procesverbale total:	116
-Adem Kadolli	67
-Kadri Sopa	54
• Kontrollime inspektuese total:	148
-Adem Kadolli	41
-Kadri Sopa	107
• Urdhëresa për sanim të gjendjes total:	93
-Adem Kadolli	/
-Kadri Sopa	93
• Aktvendime total:	64
-Adem Kadolli	21
-Kadri Sopa	24
• Gjoba mandatore total:	20

-Adem Kadolli	4
-Kadri Sopa	11
• Procedura e sipër total:	39
-Adem Kadolli	/
-Kadri Sopa	14
• Vizita në teren me kërkesa të palëve total:	119
Adem Kadolli	13
-Kadri Sopa	106

Gjithashtu jan e bërë angazhime dhe asistime me kolegët në lëmi të ndryshme brenda Drejtorisë së Inspeksionit.

Punë në terren

Janë inspektuar edhe disa hapësira publike në Rrugën "Xhavit Sylaj" në Suharekë, dhe në fshatin Mushtisht tek varrezat.

Drejtorja jonë ka dal në teren dhe ka hasur ne disa deponi ilegale por që nuk ka hasur ne ndonje fakt se kush I ka hudhur ato.

Apelojmë tek të gjithë qytetarët që të ruajnë ambientin dhe mos të bëjnë hudhjen e mbeturinave jashtë kontejnerëve, përndryshe do të përballen me ligjin

INSPEKTORI I TREGUT

Gjatë kësaj periudhe dymbëdhjetë mujore (Janar - Dhjetor, 2025). inspektorët e tregut kanë kryer detyrat e punës të parapara me Ligjet e lëmisë përkatëse, Udhëzimeve administrative dhe Vendimeve. Ka bashkëpunuar me kolegë inspektor të Komunës sonë dhe kanë marrë pjesë në aksionet sipas kërkesës nga Ministria e Tregtisë, Industrisë, Ministria e Punëve të Mbrendëshme dhe ajo për Ekonomi dhe Financa, sipër inspektimin e veprimtarive hoteliere, tregtare, furrave të bukës etj.

Inspektori ka bashkëpunuar me qytetarë dhe biznese për zbatimin e dispozitave Ligjore për të krijuar një treg konkurent dhe të besueshëm me qëllim të njoftimit të Ligjeve të reja (Vendimet) dhe duke ofruar këshilla të tjera.

Gjatë kësaj periudhe, janë kryer gjithsej:

Inspektori I Tregut: Shyqeri Fandaj, Arxhent Kuqi	
• Procesverbale	352
• Inspektime	33
• Në rregull	29
• Urdhëresa	78
• Refuzime të pranimeve teknike	82
• Aktvendim per hapje te biznesit	2
• Pranime të lokaleve	135
• Inkasimi I mjeteve nga Pranimi	7660€

Teknik	
---------------	--

INSPEKTORI I KOMUNIKACIONIT

Gjatë kësaj periudhe dymbëdhjetë mujore (Janar - Dhjetor, 2025).5, inspektori I komunikacionit ka përcjellur gjendjen e përgjithshme të komunikacionit rrugor dhe çështjet tjera në tërë territorin e Komunës së Suharekës, sipas planit përkatës, konform ligjit dhe rregulloreve në fuqi.

Gjithashtu është bërës shqyrtimi I të gjitha ankesave të qytetarëve që I përkasin lëmisë së komunikacionit dhe është vepruar sipas rregullorëve përkatëse.

Gjatë kësaj periudhe janë zhvilluar këto procedura:

Inspektor I Komunikacionit rrugor: Hysni Gallapeni	
• Procesverbale	61
• Leje Taxi	40
• Pëlqim komunikacioni	32
• Vizita në teren me kërkesa të palëve	114
• Rende te udhetimit	4

INSPEKTORI I NDËRTIMIT

Gjatë kësaj periudhe, dymbëdhjetë mujore (Janar - Dhjetor, 2025).Inspektorati i Ndertimit ka kryer detyrat e punës sipas **LIGJI Nr. 04/L-110 Ligji për ndertim ,Nr 08/L-067 Ligji për Inspektim** , Ligjeve tjera të lëmisë përkatëse, Udhëzimeve administrative dhe Vendimeve Qeveritare.

Kemi bashkëpunuar me koleget inspektor të : tregut,ambientit ,komunikaconit dhe Policinë e Kosovës si dhe kujdestaritë gjatë vikendeve si dhe jashtë orarit të rregullt të punës.Po ashtu kam Përcjellur trajnime të lamisë përkatëse.

Duke u bazuar në **“Marrveshjen për bashkëpunim” me Komunën e Mamushës** me nr te protokolit 01.Nr 016-49059 për ndihmë të ndërsjellë me staf të kualifikuar në fusha të ndryshme në kuadër te konpetencave komunale inspektorja e Ndërtimit **Vjollca Hoxha** është duke mbikqyrur ndërtimin e **Qendrës Kulturore ne Mamushë**.

Kemi bashkëpunuar me qytetar për të krijuar rregull për organizimin e organeve inspektuese në ndërtim si dhe në kompetencë të administratës shtetërore dhe komunale.

Janë pranuar kërkesa, ankesa të ndryshme për ndërtime pa leje dhe ndertimeve me leje si dhe kerkesa per inspektim gjate ndertimit dhe ju kam përgjegjur me kohë.

Janë kryer rrenime me kerkesa te drejtorive komunale te cilat kane paraqitur rrezikshmeri dhe kane penguar ne realizimin e projekteve te zbatueshme komunale.

Inspektimet e bëra janë përcjellur me procesverbal, meqë janë bërë edhe shumë inspektime pa procesverbale.

• Procesverbale totali:	265
Vjollca Hoxha	204
Liridona Asllanaj	61
• Kërkësa të palëve totali:	167
Vjollca Hoxha	102
Liridona Asllanaj	65

• Aktvendime totali:	13
Vjollca Hoxha	9
Liridona Asllanaj	4
• Nisje të procedures për kundërvajtje dhe penale në Gjykatë totali:	7
Vjollca Hoxha	5
Liridona Asllanaj	2
• Inspektive pa procesverbal totali:	1082
Vjollca Hoxha	632
Liridona Asllanaj	450
• Raporte totali:	34
Vjollca Hoxha	24
Liridona Asllanaj	10
• Urdhër	5
rrëtime totali:	
Vjollca Hoxha	4
Liridona Asllanaj	1
• Denime	/
mandatore totali:	
Vjollca Hoxha	/
Liridona Asllanaj	/
• Çertifikime	3
totali:	
Vjollca Hoxha	3
Liridona Asllanaj	/

DREJTORIA PËR KULTURË RINI SPORT DHE MËRGATË

Gjat vitit 2025 në sektorin për aktivitetet kulturore në bashkëpunim me shoqërinë civile, OJQ Kulturore Klubet Sportive dhe Individ janë organizuar disa aktivitete që shënojnë data të rëndësishme shtetërore , kulturore dhe Sportive.

Në muajin janar janë bërë përgatitjet e planifikimit programor për zhvillimin e aktiviteteve për vitin kalendarik 2025, janë zhvilluar takime konsultative dhe janë formuar këshillat organizative për organizimin e aktiviteteve të rëndësishme, antarët e këshillave kanë punuar vullnetarisht për organizimin e aktiviteteve që u zhvilluan në muajin Shkurt dhe muajin Mars. Në aktivitetin Flaka e Janarit në Gjilan nga komuna e jonë ishte ftuar GAM Theranda,

Në muajin shkurt janë zhvilluar aktivitete :


Promovimi i librit Prozë Popullore nga Podrimja autor Naim kabashi

Promovimi i librit Prozë Popullore nga Podrimja autor Naim kabashi





Hapia e ekspozitës mbarë kombëtare nga Orneta Bairaktari Ora le trare poetike e Pavarësisë



Koncert muzikor nga GAM Theranda me këngë qytetare



Koncerti i pavarësisë nga Ansambli i Këngëve dhe Valleve Shota u realizua nën patronatin e kryetarit të komunës z. Bali Muharremaj



Me ftesën e Këshilit organizativ nga Bashkia Lezhës jam ftuar për të marrë pjesë në manifestimin e kremtimit të kuvendit të leshës dhe me këtë rast u mbajt një punëtori arti me artistë nga trevat shqiptare duke kontribuar për muzeun e arteve me një piktur Kushtuar heroit ton kombëtar Gjergj kastroiti Skënderbeu

Ekspozitë me artistë vendorë dhe ndërkombëtarë
"Bota ime"
 Për nder të 8 Marsit

Afërdita Kryeziu
 Ajser Shabani
 Albulena Bilalli
 Albulena Bytyqi
 Anila Bytyçi
 Anita Ramshaj
 Arbenita Kërqeli
 Besa Kica
 Besarta Fetiu
 Dije Bllaca
 Dioneta Kabashi
 Donjete Kabashi
 Dora Labora-SHBA
 Egzona Kabashi
 Egzonë Doshllaku Haxhiu
 Elda Katija
 Era Baralija
 Ernesa Gashi

Hatë Pordimqaku
 Helen Panasiuk-Ukrainë
 Jalldeze Mustafa
 Jona Ahmeti
 Lendita Beqiri
 Leonora Ramadani
 Lida Sherafatmand-Malta
 Melisa Ukshinaj
 Nora Halimi
 Olsa Bytyqi
 Orneta Bajraktari
 Petia Hristova-Bullgari
 Pranvera Sylejmani
 Redona Kuqi
 Rina Ramshaj
 Saba Berisha Ismaili
 Sanije Dreshaj Zenuni
 Saranda Kika
 Valbona Gashi
 Zemzema Kyqyku

E PREMTË
16:00

SHTËPIA
E KULTURËS
"UKË BYTYÇI"
Suharekë

Këshill organizativ
 Era Baralija
 Fatos Kabashi
 Jehon Gallapeni

Kuratore
 Donjete Kabashi



Në Galerinë e Shtëpisë së Kulturës Ukë Bytyçi me 8 Mars është organizuar ekspozita e artit me femrat krijuese e titulluar Bota e ime e kuruar nga znj Donjeta Krasniqi Kabashi

Me rastin e ditës ndërkombëtare të Matematikës u organizua ekspozita me shkollat fillore Arti dhe Matematika.





Koncert i pinaos duo me pianistët Ledian Shala dhe Agron Shujaku




Nga data 7 deri me daten 16 mars U realizua puntoria inovative dhe artistike inspirim nga Bleta, Në bashkëpunim me Artaction Group me profesorëtn ga universiteti Adelphi New York SHBA Dhe Universiteti shtetror i Pensilvanisë SHBA, nga shtëpia e Fellbahut rreth 50 të rinjë moren pjesë nga grupi i artit, robotikës ,baletit dhe klasa e gjuhës angleze, pas përfundimit u hap ekspozita me krijimet artistike dhe innovative.



Me 26 Mars u organizua Akademi përkujtimore në kujtim dhe nderim të viktimave civile nga Komuna e Suharekës të rënë gjat luftës.me këtë rast të pranishmit i përshëndeti Kryetari i Komunës Z.Bali Muharremaj dhe Andin Hoti kryetar i komisionit qeveritar për të pagjeturit, me program artistic u angazhua GAM Theranda

Me 26 Mars u mbajt promovimi i librit Masakra serbe në Komunën e suharekës 1998-1999Me autor Milazim Elshani dhe Rahman Rexhaj





Me rastin e përkujtimit për Heroin Besim Ndreca u mbajt akademi përkujtimore dhe homazh. Me rastin e kremtimit të ditës së çlirimit u realizuan aktivitetet sipas agjendës së paraparë

KOMUNA E SUHAREKËS		
13 QERSHORI, DITA E ÇLIRIMIT DHE DITA E DËSHMOREVE NË SUHAREKË		
FTESË		
Ftoheni që të merrni pjesë në aktivitetet e kremtimit të 13 Qershorit, Ditës së Çlirimit dhe Ditës së Dëshmorëve të Komunës së Suharekës		
Me respekt Kryetari i komunës, Z. Bali Muharremaj		
Agjenda e kremtimit 13 Qershorit, Ditës së Çlirimit dhe Ditës së Dëshmorëve të Komunës së Suharekës 13.06.2025		
Koha	Aktiviteti	Vendi
09:00	pritja e musafirëve	Objekti i Komunës së Suharekës
10:00	Homazhe	Tek Parku i Dëshmorëve, përmendoret e heronjëve, përmendroja e martirëve, dhe tek varri i Ukë Bytyçi në Semetisht;
11:00	Homazhe	Tek përmendroja e gazetarëve Gjermanë në Qafë të Duhlës
11:15	Homazhe	Tek varrezat e dëshmorëve në Carralevë;
12:00	Akademia solemne	Në Shtëpinë e Kulturës "Ukë Bytyçi"
19:20	Takimi i veteranëve	Në Oborrin e Komunës së Suharekës
19:45	Defileu i veteranëve	Nga Komuna deri te Sheshi i Qytetit
20:00	Koncerti festiv	Tek Sheshi i Qytetit

KOMUNA E SUHAREKËS	
13 QERSHORI, DITA E ÇLIRIMIT DHE DITA E DËSHMOREVE NË SUHAREKË	
KONCERT FESTIV	
13 QERSHOR TE SHESHI I QYTETIT	
ORA 20:00	
GAM "THERANDA" ORGANIZON PROGRAM ARTISTIK	
Emri i këngës	Emri i solistit, gr.
Valle popullore	Grupi i vajzave- Shirokë
"Pa bashkim nuk të ruaj"	Grupi i burrave
"Hej Kosovë tokë e bekuar"	Fortesa Zyba
"Dil moj kang nga zemra ime"	Regjep Seferaj
"Të falim Kosovë"	Lina Ahmetaj
"Ai është gjallë"	Erlenda Jashari
"Valle me motive kosovare"	Grupi i valleve
"Këngë për dëshmoret"	Beqir Gashi
"Këngë për Tahir Sinanin"	Donjeta Haziraj
"Kosovë nana ime"	Endi Binaku
"Era e marsit fryn"	Erlenda Bytyqi
"Liridona"	Faton Ibrahim
"Fjalët e qirrit"	Dafina Morina
"Mos më shkel me kamb n'oborr"	Shani Shala
"Ç'jan kto xhamë që për i bjen era"	Grupi i burrave
"Këngë për Muj Krasniqin"	Dafina Morina
"Valle me motive nga Shala e Bajgorës"	Grupi i valleve
Grupi vokal:	
Fazli Morino, Ramadan Kryeziu, Shani Shala, Sherif Cikaqi, Faton Ibrahim, Flanik Shala, Ardit Cikaqi	
Orkestra:	
Nazim Berisha - Klarinet, Agon Morina - Klarinet, Sherif Cikaqi - Qifteli, Hektor Kryeziu - Sint- bass, Genc Behluli - Kitarë, Naim Baftjaraj - Perkusione	
Udhëheqës orkestre:	
Hektor Kryeziu	
Udhëheqës artistik:	
Shani Shala	

Me rastin e kremtimit të ditës së çlirimit u realizuan aktivitetet sipas agjendës së paraparë



Me rastin e akademisë solemne u përgatit programi artistik me këngë korale nga GAM Theranda



Koncerti festiv u mbajt në sheshin e qytetit i organizuar nga GAM Theranda me një program të pasur artistik me këngë dhe valle.



Pranvera poetike e therandës dhe konkursi për qmimin në poezi “Ragip Sylaj” u realizua nga OJQ SHAK Elena Gjika Dora D'Istria, në këtë manifestim tradicional moren pjesë poet nga trevat mbar kombëtare. Fituese e çmimit Ragip sylaj ishte poetja nga Theranda Sherife Berisha Thaqi. Me krijimet letrare të pjesëmarresve në konkurs u botua libri Prranvera Poetike e Therandës nr 2.

Punët administrative që kam kryer gjatë 6 muajve : Janar.Shkurt. Mars, jan kryer shumë punë administrative si pranimin e kërkesave, ankesave , njoftimeve , faturave dhe shqyrtimin e tyre, takime me OIQ të ndryhme. Kam përfunduar raportin përfundimtar të ojqe- për vitin 2024 të kërkuar nga Zyra për Qeverisje të Mirë /Zyra e Kryeministrit , përcjelljen e aktiviteteve të ndryshme dhe kryerjen e obligimeve financiare nga viti 2024 si dhe pagesa të këtij viti , si dhe punë të tjera me kërkesë të drejtorit.

Gjat muajit maj dhe qershor jan kryer aktivitetet si përgatitja e materialeve për thirrjen publike për fushen e kulturës, sportit Rinisë dhe Mërgatës dhe aktivitetet në komisionin për vlersimin e projekteve.

Të rinjët në aksion për mbrojtjen e ambientit. Në bashkëpunim me shkollat dhe kompanitë e pastrimit u oeganizua një aksion i madh për pastrimin e Mbeturinave




Në shtëpinë e Kulturës Ukë Bytyçi me rastin e kremtimit të Ditës së Shkollës të Gjimnazit "Jeta e Re" u shfaq një program artistic i përgatitur nga nxënësit dhe arsimtarët e Gjimnazit.



Në Shtëpinë e Kulturës “ Ukë Bytyçi u shfaq, shfaqja teatrale për fëmijët e shkollave fillore në Suharekë, Shfaqja teatrale “Vreshti” u interpretua nga aktorët e tetrit profesional nga Ferizaji,



Në shtëpinë e Kulturës u shfaq Premjera e shfaqjes “Jetë a Vsdekje” nga trupa teatrale e të rinjëve nga Shtëpia e Fellbahut për realizimin e shfaqjes u angazhuan profesorët Shani Shala, Hektor Kryeziu dhe Refki Gollopi.Në këtë shfaqje luftohen dukurit negative në moshat e reja. Për ta realizuar këtë shfaqje u angazhuan 20 talent të rinjë nga komuna e jonë.



Më 21 maj 2025, në Mushtisht u përrua Shtëpia e re e Kulturës “Afërdita” – një projekt i rëndësishëm i realizuar nga Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport dhe Mërgatë.



Ecja në Natyrë – “Drejt Malit”

Ky aktivitet kishte për synim promovimin e aktivitetit fizik në natyrë, edukimin mjedisor dhe zhvillimin social të nxënësve, në një atmosferë motivuese dhe gjithëpërfshirëse.



Ekspozita përkujtimore “Në hapat e tyre të lirisë” i kushtohet fëmijëve të rënë gjat luftes 1998-1999. Autor të kësaj ekspozite janë Kastriot Veselaj dhe Beqir Palushi.



Sektori i Bibliotekës

Gjatë periudhës janar–qershor 2025, Biblioteka “Hajdin Berisha” ka realizuar me sukses misionin e saj në ofrimin e shërbimeve për lexuesit dhe komunitetin në përgjithësi. Të dhënat statistikore për këtë periudhë janë si më poshtë:

- Numri i përgjithshëm i lexuesve të regjistruar: 864
- Numri i përgjithshëm i librave të lexuar: 3247

Sektori i Fëmijëve:

- Lexues të regjistruar: 631
- Ndërrime të librave: 2537

Sektori i të Rriturve:

- Lexues të regjistruar: 233
- Ndërrime të librave: 710

Salla e Leximit:

- Përdorues të sallës së leximit: 1779

Libra të rinj të shtuar në fondin e bibliotekës: 101

I. AKTIVITETET KULTURORE DHE EDU KATIVE

Gjatë këtij gjashtëmujori, Biblioteka ka organizuar një sërë aktivitete që kanë pasuruar jetën kulturore dhe kanë rritur ndërveprimin me lexuesit:

- 24 Mars – Vizita e nxënësve të shkollës “7 Marsi” me rastin e Ditës Botërore të Gjuhës Amtare;
- 17 Shkurti – Vizita e organizuar në bibliotekë nga shkolla fillore e fshatit Shirokë.
- 2 Prill – Dita Botërore e Librit për Fëmijë, me pjesëmarrjen e nxënësve të:
 - Shkollës “Lidhja e Prizrenit” – Budakovë
 - Shkollës “7 Marsi” – Suharekë
 - Kopshtit “Ora” – Suharekë

(Fëmijëve iu lexua një përrallë nga shkrimtari **Fadil Bytyqi**)

- **23 Prill – Dita Botërore e Librit**, shënuar me aktivitete letrare dhe prezencë të lexuesve të rinj;
 - **Promovimi i librit “Sythat e dritëhijeve të jetës”** nga autorët **Sedat Gashi** dhe **Miranda Fondaj**;
 - **Promovimi i librit “Shpirti më tha”** nga autorja e re **Laureta B. Reshani**;
 - **Vizita e shkrimtarit Hamit Gurguri** në Bibliotekën “Hajdin Berisha”;
 - **Promovimi i librit “Xhemajl Ramaj- Uragan i Lirisë”- Fikret Ramaj**;
 - **Pjesëmarrja e stafit në konkursin e poezisë “Ragip Sylaj”**;
-

II. RAPORTI I PËRPUNIMIT TË LIBRAVE DHE I SHËRBIMEVE

Biblioteka ka zhvilluar dhe zbatuar praktika të mirëfillta profesionale në fushën e përpunimit të librit dhe ofrimit të shërbimeve bibliotekare:

- Hartimi i thirrjes për interesuarit për krijimin e dy klubeve të leximit;
- Hartimi i **planeve zhvillimore dhe vjetore**, si dhe raportimi mbi rezultatet;
- **Menaxhimi financiar dhe administrimi i mjeteve materiale** të siguruar nga participimi;
- **Përpunimi i librave të dhuruar**, përfshirë:
 - Caktimin e signaturave sipas **sistemit KUD**
 - Regjistrimin në **libër inventari**
- **Shërbimet për lexuesit**:
 - Ndërrimi i librave dhe **konsultimi**;
 - Ofrimi i **informacionit dhe orientimit**;
 - **Mbikëqyrja e aktivitetit** brenda ambienteve të bibliotekës.
- Kujdes i veçantë ndaj **librave të humbur** dhe zëvendësimi i tyre;
- Hartimi i **listës për blerje të librave** dhe adresimi në MKRS.

Trashegimia Kulturore:

Në sektorin e trashëgimisë kulturore janë zhvilluar aktivitetet rutinore në muzeun e qytetit janë zhvilluar vizita nga qytetarët dhe nxënësit shkollave dhe janë organizuar vizita në teren në për të përciell gjendjen e asetëve të brojtura të trashëgimis kulturore.

Sport:

Në palestren e sportit 13 Qershori janë zhvilluar aktivitete të rregullta sipas orarit, Trajnimet e shkollave sportive dhe klubeve.

Janë zhvilluar garat e rregullta sportive sipas ligave në sportet e ndryshme në basketboll, volejboll shigjetari dhe garat e sportit shkollor - volejboll në nivel rajonal dhe lokal. ndersa garat e superliges së futbollit janë zhvilluar nga të dy klubet tona të cilat zhvillojnë në kuadër të superliges dhe siaps orarit në stadjumin e qytetit dhe si musafir.

Garat komunale në volejboll, në këto gara morën pjesë ekipet e shkollave nga komuna e jonë, vlen të përmendet disiplina dhe përgatitja sportive e ekipeve.

RAPORTI STATISTIKOR

Gjatë periudhës janar–dhjetor 2025, Biblioteka Hajdin Berisha ka realizuar me sukses misionin e saj në ofrimin e shërbimeve bibliotekare për lexuesit dhe komunitetin në përgjithësi, duke dëshmuar një angazhim të vazhdueshëm në promovimin e leximit dhe kulturës.

Të dhënat statistikore për këtë periudhë janë si më poshtë:

Sektori / Përshkrimi	Numri
Numri i përgjithshëm i lexuesve të regjistruar	1,327
Numri i përgjithshëm i librave të lexuar	7,695
Sektori i Fëmijëve – Lexues të regjistruar	900
Sektori i Fëmijëve – Ndërrime të librave	4,813
Sektori i të Rriturve – Lexues të regjistruar	427
Sektori i të Rriturve – Ndërrime të librave	2,882
Salla e Leximit – Përdorues	3,244

Biblioteka ka zhvilluar dhe zbatuar praktika të mirëfillta profesionale në fushën e përpunimit të librit dhe ofrimit të shërbimeve bibliotekare:

- Hartimi i thirrjes për interesuarit për krijimin e dy klubeve të leximit;
- Hartimi i planeve zhvillimore dhe vjetore, si dhe raportimi mbi rezultatet;
- Menaxhimi financiar dhe administrimi i mjeteve materiale të siguruar nga participimi;
- Përpunimi i librave të dhuruar, përfshirë:
 - o Caktimin e signaturave sipas sistemit KUD
 - o Regjistrimin në libër inventari
- Shërbimet për lexuesit:
 - o Ndërrimi i librave dhe konsultimi;
 - o Ofrimi i informacionit dhe orientimit;
 - o Mbikëqyrja e aktivitetit brenda ambienteve të bibliotekës.
- Kujdes i veçantë ndaj librave të humbur dhe zëvendësimi i tyre;
- Hartimi i listës për blerje të librave dhe adresimi në MKRS.

Edhe në gjashtmuorin e dytë u organizuan shumë aktivitete sportive përveq klubeve që garojnë në ligat sportive të republikës. Njëherit u përruan objekte të reja të infrastrukturës sportive. Në shenjë të përhershme me popullin amerikan dhe kombin e Amerikës, sot në stadiumin e FC Ballkanit u organizua një ndeshje me grupin futbollistik U1. Ky aktivitet u organizua nga Kosova hop në bashkëpunim me shkollën e futbollit FC Ballkani dhe DKRSM

TREJNERET E SUKSESËM TË VITIT 2025

1. Valmir Fetiu –Taekwondo&HAPKIDO “Puma” Suharekë nderohet me mirënjohje si trajner I vitit 2025
2. Avni Kuçi – AeroKlubi (Shqiponja e Art) –trajneri I dalluar për vitin 2025
3. Edon Gashi – FC Ballkani trajneri I dalluar në vitin 2025
4. Hasan Bytyçi – Shkolla e Basketbollit” Theranda Basket” - trajneri I dalluar për vitin 2025
5. Valon Mustafa – Klubi I Volejbollit Theranda- trajner i dalluar për vitin 2025
6. Emerlla Krasniqi- Klubi I futbollit “Studençani” trajner i dalluar për vitin 2025 Punëtorët sportiv-
 1. Drilon Berisha – Shkolla E Futbollit Suhareka-punëtor më i suksesshëm i vitit 2025
 2. Bashkim Ndrecaj – FC Suhareka ’23- punëtor I dalluar për vitin 2025
 3. Labinot Bytyçi – FC 13 Qershori punëtor I dalluar për vitin 2025
 4. Agron Kelmendi – Theranda Motokros punëtor I dalluar për vitin 2025
 5. Meriton Kryeziu – FC Ballkani punëtor I dalluar për vitin 2025

Donatorët e vitit 2025

1. EUROING , CIMA GRUP, NTP ETIKA SHPK, DIGITAL L.L.C, TAFA & CO , SEFERI GROUP, AAB CONTRUCTION, KASTRATI CENTER dhe EMSA

Pedagogët e vitit 2025

Pedagogu i Vitit – Nehat Berisha nderohet me mirënjohje për rezultatet e arritura në nivel komunale dhe regional. Senad Haxha nderohet me mirënjohje për angazhimin e tij të vazhdueshëm në zhvillimin, organizimin dhe promovimin e sportit shkollor.

Shpresat e vitit 2025 nderohet me mirënjohje-shpresat e vitiit

1. Valina Fetiju – Shpresë e Vitit 2025
2. Feslind Graishta – FC Ballkani
3. Lisa Kabashi – KV” Gjinoci “
4. Loris Elshani – Shkolla e Basketbollit ” Theranda Basket”
5. Altin Berisha –Shkolla e Basketbollit” Theranda Basket “
6. Drinor Morina – Shkolla e Futbollit “Studençani “
7. Ari Bejtullahu – Shkolla e Futbollit “Studençani “
8. Eurolind Morina – Theranda Motocross
9. Arzana Blaca – KLubi i Triathlonit Suhareka
10. BlearG Gashi – Klubi I Triathlonit SuHAREKA
11. Elda Reshani – KV. Theranda (F)
12. Anik Buzhala – Shkolla e futbollit” Suhareka “
13. Bledi Kuçi – KLubi I Volejbollit” Theranda “
14. Rona Ramaj – KV” Gjinoci 94”
15. Alea Gashi – KV”Gjinoci 94 “

SPORTISTËT E VITIT 2025

1. Selina Gashi – Klubi Triathlonit Suharekë
2. Veton Sylja – Aeroklubi “Ballanat e Sahit Ukës”
3. Enkela Voci - KV”Gjinoci”
4. Leonard Shala – KF Suhareka 23
5. Fatlind Berisha – KF Studençani 77
6. Fatlum Jashari – Klubi I Futsallit 13 Qershori 7 Nerënxa Kuçi – Klubi Atletikë Theranda 1992
8. Denard Krasniqi – Klubi Atletikë Theranda 1992
9. Kastriot Muça – Klubi I Automotos” Theranda Motocross”
10. Miranda Shala – KV. Theranda (F)
11. Latife Lushaj – KV” Ginoci 94”
 8. Safet Sylaj –Aeroklubi Shqiponja e Artë
 9. Etnik Ndrecaj –Shkolla e Basketbollit “Theranda Basket”

Mirënjohje I ndahet: FC Ballkani - Klubi më i suksesshëm për vitin 2025

Duke u bazuar në rregulloren e Ministrisë së Financave NR.-04/2017 mbi Kriteret Standardet dhe Procedurat e Financimit Publik të OJQ-ve, bazuar në vendimin me numer protokoli 01 –Nr.410-28110 të datës 15.05.2025 për formim të komisionit për vlerësimin e projekteve të dorëzuara nga OJQ-të, Komisioni vlerësues nxjerr këtë:

VENDIM**PËRFUNDIMTAR PËR SUBVENCIONIMIN E OJQ-VE**

Në përputhje me afatet dhe detyrta e komisionit të përcaktuar në vendimin e lartë përmendur dhe duke u bazuar në Thirrjen Publike të datë 17.04.2025 me tematike kulturë, rini, sport, komisioni ka shqyrtuar dhe vlerësuar të gjithë dokumentacionin përkatës të dërguar nga OJQ-të, ku sipas kriterëve komisioni vlerësues ka shpallur Listën Përfundimtare të përfituesve për subvencionim të këtyre OJQ-ve:

Emri i oj-q-ve

	Përfituesi	Titulli i projektit	Fusha
1.	10-181-27233 KV”Gjinoci 94”	Organizmi i beach volleyit për femra dhe fuqizimi i oj-q-së	Sport 2920€
2.	10-181-26603 Klubi i Volejbollit “Theranda –	Përkrahja dhe avancimi i volejbollit të femrave në Suharekë dhe Kosovë	Sport 2800€
3.	10-181-27337 Off road Theranda	Organizmi i garave ndërkombetare në kuadër të ditëve të Mërgatës dhe Festari 2025	Sport 3500€
4.	10-181-27358 AEROKLUBI SHQIPONJA E ARTE	Pjesëmarrja e pilotëve në garat Kombetare dhe Ndërkombetare	Sport 4000€
5.	10-181-27328 FC SUHAREKA 23	Pjesëmarrja në gara në kuadër të Federatës së Futbollit të Kosovës	Sport 80.000€
6.	10-181-27109 Shkolla e basketbollit Theranda basket	Aktivizimi i gjeneratave të reja në konkurrencën e femrave	Sport 4800€
7.	10-181-26362 Shkolla e futbollit Suhareka	Zhvillimi i kampionatit i2025/2026 në kuadër të Federatës së Futbollit të Kosovës dhe LRF Prizren dhe Pjesëmarrja në turnirin mbarëkombëtarë Ulpiana Cup në Durrës	Sport 5000€
8.	10-181-25089 Klubi i Karates Çeliku	Zhvillimi i kampionatit 2025/2026 në kuadër të Federatës të Karates së Kosovës	Sport 1650€
9.	10-181- 25843 Teakwondo Hapkido Puma	Gara Ndërkombëtare dhe Kombëtare	Sport 4400€
10.	10-181-27009 KSH LUZHINICA	Masovizimi i Shigjetarisë në Suharekë -Klubi i Shigjetarisë Luzhnica	Sport 1630€

11.	10-181-27412 KV”GJINOCI”	Zhvillimi i kampionatit në kuadër të Federatës së volejbollit të Kosovës me senior dhe grupmoshat e reja sezona 2025/2026	Sport 10.600€
-----	-------------------------------------	---	-------------------------

12.	10-181-26601 KV THERANDA MESHKUJT	Zhvillimi i voleybollit të meshkujve dhe pjesëmarrja në gara kombëtare dhe ndërkombëtare	Sport 4900€
13.	10-181-27392 FC 13 QERSHORI	Garat kampionale në Superligën e Futsallit	Sport 7000€
14.	10-181-26925 Sporti Shkollor Suhareke	Organizmi i garave shkollore në nivel komunal për SHFMU dhe SHML në Suharekë	Sport 3,496€
15.	10-181-27138 Klubi Triathlon-Suhareka	Masovizimi i sportit për të rinjtë përmes kampeve dhe garave që do të organizohen në kuadër të Federatës të Triathlonit të Kosovës me qëllim të aftësimit të të rinjëve në vozitjen e bicikletës mesim noti dhe vrapimi	Sport 2300€
16.	10-181-27136 Klubi i Atletikës Theranda 1992	Masovizimi i atletikës përmes pjesëmarrjes në gara vendore , rajonale dhe ndërkombetare & vrapimi i 28 Nëntorit	Sport 6678€
17.	10-181-26999 Ndërto shoqëri pa injorance	Bota përtej ekranit	Rini 1602€
18.	10-181-26609 Ojq HANDIKOS	Fuqizimi i PAK-ve përmes aktiviteteve kulturore dhe sportive	Sport 7000€
19.	10-181-27122 ACTIVE CREATIVE YOUTH	Vallëzimet dhe melodite e paqes	Kulturë 3000€
20.	10-181-24001 Ojq-IVB	Festivali i teatrove Suharekë 6	Kulturë 3000€
21.	10-181-25692 Kryqi i Kuq –Dega Suhareke	Sfidat e brezit të ri, dukuritë negative që prekin të rinjtë sot	Kulturë 2750
22.	10-181-260052 Shoqata Art Fest	Organizimi i edicionit të tretë të Festivalit Art Fest	Kulturë 4000€
23.	10-181-27357 Alternativa per Integrim	Gjithcka fillon me një fjalë –ndalojmë bullizimin dhe dhunën në shkolla	Rini 1544€
24.	10-181-24864 Ojq-ELITA	Gjenerata e humbur në botën virtuale(teknologjia)	Rini 5000€
25.	10-181-27104 FGRS	Arti barazisë-Fuqizimi i vajzave përmes ligjit dhe krijimtarisë	Rini 1310€
26.	10-181-26930 OJQ-AUTIZIMI	Përmisimi i sjelljeve pozitive për fëmijët autik dhe me sindrom down	Rini 1100€
27.	10-181-27072 Syte kerkojne drite	Takohemi në ekspozitë	Rini 3200€
28.	10-181-27204 Shoqata Filum Granum	Trajnimi i të rinjëve me teori dhe punën praktike rreth artizanatit të filigranit	Kulturë 1500€
29.	10-181-27070 ALB OBCURA FILMS”,	Vneshta	Kulturë 5550€
30.	10-181-26512	Suhareka Fest	Kulturë

	OJQ"PRIZREN FEST		5000€
31.	10-181-26697 ELENA GJIKA DORA D`ISTRIA	Aktivitetet tradicionale te SHAK Elena Gjika Dora D`istria	Kulturë 6810€
32.	10-181-266675 Ojq Morea	12 Gushti -Shëndet dhe Fuqi për Rini –	Rini 1800€
33.	10-181-27325 Gam Theranda	Jeta muzikore"Therandase Suhareka 2025"	Kulturë 25.000€
34.	10-181-27263 OJQ"OCARINA	Ekspozita arkeologjike e Hisarit dhe Katalog i Hisarit-	Kulturë 2660€
35.	10-181-27315 OJQ -Ikat Hisari	Të rinjët në veprim :Kujtesë, Trashëgimi dhe Aftësi për të Ardhmen-	Kulturë 2100€
36.	10-181-27311 Shoqata e te verbërve Suhareke	Të dëgjojmë zërin që sjell ndryshime	Kulturë 1650€
37.	10-181-26698 OJQ-AIPK	Hyjnesha në Fron	Kulturë 3151€
38.	10-181-27270 OJQ-Forum i Shqipëtar për Kulturë dhe Trashëgimi	E ardhmja kujdeset për të kaluarën-	Kulturë 2075€
39.	10-181-27318 OJQ-Aria	Aktivitetet kulturore te Ojq-ARIA 2025.	Kulturë 23.500€
40.	10-181-27336 Shoqata e zjarrefikseve Suhareke	Vetëdijesimi i qytetarëve dhe nxënësve për parandalimin e zjarrëve	Rini 1270€
41.	10-181-27003 OJQ-THERANDA E RE	Organizmi i aktiviteteve kulturore te komunes se Suharekës	Kulturë 2500€
42.	10-181-27245 SHKA- JEHONA	Jehona e Artit	Kulturë 5000€
43.	10-181-27119 Shoqatra e te Shurdhurve Suhareke	Aktivitetet sportive dhe trajnime	Sport 1500€
44.	10-181-27212 Mitrix CULTURE	Java e Filmit në Suharekë	Kulturë 6750€
45.	10-18127469 Drite ne Syte tanë	Luftimi i dukurive negative përmes edukimit jo formal-	Rini 1520€
46.	10-181273199 KB"GOLEDEN EAGLE YLLI"	Zhvillimi i kampionatit në kuadër të federatës së bask. për grupmoshat e reja sezoni 2025/2026 –	Sport 20.200€
	TOTALI I SUBVENCIONEVE PER OJQ-të nga thirrja publike 2025	=====	295.716€

Po ashtu jnaë shpenzuar edhe **46.300€**- subvencione obligime të pa paguara nga viti 2024 Mallra shërbime janë shpenzuar **90.000€**

Investime kapitale :

NDËRTIMI I KULLËS SË DËSHMORËVE NË BUDAKOVË" NDËRTIMI I MEMORILIT "TE GURRA E KADISË "
"NDËRTIMI I KULLËS SË DËSHMORËVE NË DOBERDELAN

Stadiumi i ri do të ketë 6 mijë e 583 ulëse dhe do të ndërtohet sipas standardeve të kategorisë 2+, ka bërë të ditur drejtori i Departamentit të Sportit në MKRS, Ibër Alaj. Sipas tij, punimet do të zgjasin 750 ditë nga dita e sotme.

Në ceremoninë e vendosjes së gurthemelit morën pjesë kryeministri në detyrë, Albin Kurti, ministri në detyrë i Sportit, Hajrulla Çeku, kryetari i Komunës së Suharekës, Bali Muharremaj, si dhe kryetari i Federatës së Futbollit të Kosovës, Agim Ademi.



Aktivitetet e tjera te detajuara realizuara nga drejtoria jane te publikuar ne raportin e drejtorise ne linkun:
<https://suhareke.rks-gov.net/raporti-vjetor-2025-2/>

DREJTORIA PËR URBANIZËM PLANIFIKIM DHE MJEDIS

1. Përshkrim i shkurtër i aktiviteteve për vitin 2025

Viti 2025 për Drejtorinë për Urbanizëm, Planifikim dhe Mjedis karakterizohet nga angazhimi në planifikimin e qëndrueshëm urban, menaxhimin e territorit, mbrojtjen e mjedisit dhe përmirësimin e shërbimeve ndaj qytetarëve. Aktivitetet që kemi mbajtur synojnë zhvillim të balancuar urban, rritje të transparencës dhe zbatim efikas të akteve ligjore dhe nënligjore.

DUPM është marrë me shqyrtimin e kërkesave të ndryshme. Gjatë këtij viti kemi pranuar gjithsejt 379 lëndë të rregullta dhe janë përcjellë 754 shkresa dalëse, ndërsa në Legalizim janë pranuar gjithsejt 129 lëndë kurse janë përcjellë 381 shkresa dalëse.

Kryesisht kemi pranuar kërkesa për:

- a. Kushte Ndërtimore,
- b. Leje Ndërtimore,
- c. Leje Rrërimi,
- d. Leje Mjedisore,
- e. Renovim,
- f. Shfrytëzim të Hapësirës Publike,
- g. Përshkrim Parcele,
- h. Pëlqim në Parim,
- i. Sinjalizim Horizontal dhe Vertikal,
- j. Emërtim i Rrugëve,
- k. Qasje në Dokumente Zyrtare,
- l. Legalizim i Objekteve si dhe
- m. Çertifikim të objekteve të ndërtuar me leje ndërtimi.

Shkresat dalëse të DUPM-së:

- a. Aktvendim mbi Kushte Ndërtimore,
- b. Aktvendim mbi Leje Rrërimi,
- c. Aktvendim mbi Leje Ndërtimore,
- d. Aktvendim mbi Leje Mjedisore,

- e. Pëlqim për Shfrytëzim të Hapësires Publike,
- f. Pëlqim në Parim dhe të Ndryshme,
- g. Njoftim për Pagesë për lëndë të ndryshme,
- h. Plotësim Lëndë për lëndë të ndryshme,
- i. Raporte rreth Planeve Rregulluese të Hollësishme,
- j. Bonuset e Zonimit
- k. Njoftime të ndryshme,
- l. Përgjigje rreth Kërkesës,
- m. Refuzime të Ndryshme,
- n. Përshkrim Parcele,
- o. Çertifikatë Legalizimi,
- p. Listë e Pritjes,
- q. Regjistrim në Kadastër rreth kërkesave të Legalizimit.

Punë tjera në DUPM gjatë vitit 2025:

- a. Përcjellja e procesit të PRrH “Zona Ekonomike në Duhël”
- b. Përcjellja e procesit të PRrH “Zona Industriale në Shirokë”
- c. Përcjellja e procesit rreth bonueseve të zonimit,
- d. Dalje në teren për landë të ndryshme,
- e. Raporte të ndryshme për zyrën e kryetarit, drejtoritë e ndryshme, Ministritë përkatëse dhe Auditorët,
- f. Insektimi i objekteve të kategorisë II siç e përcakton ligji për trajnimin e objekteve pa leje,
- g. Menaxhimi dhe mbikqyrja e projekteve kapitale që kanë qenë nën kompetenca tëDUPM-së dhe drejtorive të tjera.

Të bashkangjitur keni raportin në formë tabelare dhe grafike të lëndeve dhe të hyrave financiare të Drejtorisë për Urbanizëm, Planifikim dhe Mjedis.

Lënde të Rregullta

<i>Lloji i Kërkesës:</i>	<i>Lëndë të Pranuar</i>	<i>Të Aprovuara:</i>	<i>Të Refuzuara</i>	<i>Në Proces</i>
<i>Leje Rrërimi:</i>	07	07	/	/
<i>Kushte Ndërtimore:</i>	52	30	19 (1-Pezullim, 1-Tërheqje nga Procedura, 1-Shtyerje Afati)	03
<i>Leje Ndërtimore:</i>	28	30	02	03
<i>Leje Mjedisore:</i>	24	15	03 (1-Tërheqje nga Procedura, 2-Përgjigje në Kërkesë,)	03
<i>Përshkrim Parcele:</i>	11	11	/	/
<i>Shfrytëzim i Hapësires Publike:</i>	49	27	13 (1-Njoftim, 7-Pezullim, 1-Përgjigje në Kërkesë)	/
<i>Çertifikatë e Përdorimit</i>	02	01	/	01
<i>Të Tjera:</i>	Të tjera: 202	754 (shkresa dalëse)	/	-

Lëndet e Legalizimit

<i>Lloji i Kërkesës:</i>	<i>Lëndë të Pranuar</i>	<i>Të Aprovuara:</i>	<i>Të Refuzuara</i>	<i>Në Proces</i>
--------------------------	-------------------------	----------------------	---------------------	------------------

<i>Certifikatë Legalizimi:</i>	129	131	/	71
<i>Listë e Pritjes:</i>	-	21	-	-
<i>Plotësim Lënde:</i>	-	37	-	-
<i>Njoftim për Pagesë:</i>	-	64	-	-
<i>Njoftim për Kadastër:</i>	-	119	-	-
<i>Njoftim për Legalizim:</i>	-	07	/	/

Barazimi i të Hyrave Financiare për periudhën Janar – Dhjetor 2025

Muaji	Vlera:
Janar	62,103.37
Shkurt	23,221.32
Mars	15,212.98
Prill	63,478.24
Maj	12,825.53
Qershor	6,910.67
Korrik	79,338.68
Gusht	57,052.29
Shtator	120,325.47
Tetor	63,939.35
Nëntor	10,876.58
Dhjetor	36,698.74
Total:	551,983.22

2. Objektivat Kryesore të Vitit 2025

- Zhvillimi dhe përmirësimi i planifikimit urban dhe hapësinor,
- Rritja e efikasitetit në procesin e urbanizimit dhe ndërtimit,
- Mbrojtja dhe përmirësimi i mjedisit,
- Forcimi i inspektimit dhe kontrollit urbanistik,
- Rritja e transparencës dhe bashkëpunimit institucional.

3. Fushat Kryesore të Veprimtarisë dhe Aktivitetet

3.1. Planifikimi Urban dhe Hapësinor

- Hartimi, rishikimi dhe zbatimi i planeve urbanistike dhe planeve rregulluese
- Zbatimi i Planeve Vendore të Zhvillimit
- Përdorimi racional i territorit dhe mbrojtja e hapësirave publike
- Koordinimi me institucione të tjera për planifikimin territorial

3.2 Urbanizimi dhe Ndërtimi

- Shqyrtimi dhe trajtimi i kërkesave për leje ndërtimi
- Kontrolli i dokumentacionit teknik dhe ligjor
- Monitorimi i zbatimit të lejeve të ndërtimit në terren
- Përmirësimi i procedurave administrative për shërbime më efikase

.3 Mjedisi dhe Mbrojtja e Natyrës

- Monitorimi i gjendjes mjedisore në territor
- Zbatimi i projekteve për gjelbërim dhe përmirësim të hapësirave publike
- Bashkëpunimi në menaxhimin e mbetjeve dhe reduktimin e ndotjes
- Ndërgjegjësimi i komunitetit për mbrojtjen e mjedisit

3.4 Inspektimi dhe Kontrolli Urbanistik

- Parandalimi dhe trajtimi i ndërtimeve pa leje
- Inspektime të rregullta në terren
- Zbatimi i masave administrative sipas ligjit
- Bashkëpunimi me organet inspektuese dhe ligjzbatuese

3.5 Bashkëpunimi Institucional dhe Transparenca

- Bashkëpunimi me drejtoritë e tjera dhe institucionet përkatëse
- Informimi i qytetarëve mbi procedurat urbanistike
- Përmirësimi i komunikimit me publikun dhe palët e interesuara

4 Rregullorja e Bonuseve të Zonimit

Me datë 08.01.2025 u mbajt takim pune për rregulloren e bonuseve të zonimit me grupin punues dhe zyrtarët e drejtorisë ku qëllimi i këtij takimi ishte që kjo rregullore të mundësoj përdorimin e mekanizmit të bonuseve të zonimit si mjet zhvillimor.

Përmes kësaj rregullore synojmë të krijojmë një balancë të drejtë mes interes publik dhe privat, duke mundësuar zhvillim të qëndrueshëm urban dhe përfitime konkrete për komunitetin.

Ekipi i kësaj rregulloreje ka zhvilluar një seri takimesh pune gjatë këtij viti me qëllim shqyrtimin e bonuseve të zonimit dhe harmonizimin e tyre me planet urbanistike.

Rregullorja përcakton llojet e bonuseve të zonimit, kriteret për përfitim, zonat ku ato aplikohen, kufijtë maksimalë të bonusit, si dhe detyrimet që lindin për subjektet përfituese

Zbatimi i kësaj rregulloreje pritet të kontribuojë në zhvillim të kontrolluar urban, përmirësim të cilësisë së ndërtimeve, mbrojtje të interesit publik dhe rritje të transparencës në proceset urbanistike.

Gjatë hartimit të rregullores është siguruar bashkëpunim ndërinstitucional dhe konsultim teknik për garantimin e zbatueshmërisë së saj.

Puna e realizuar në kuadër të kësaj rregulloreje ka rezultuar në përgatitjen e draft-planit për bonuset e zonimit, i cili do të ndjekë hapat proceduralë përkatës dhe parashikohet të miratohet nga institucionet kompetente në vitin 2026.

5.Plani Rregullues i Hollësishëm për “Zona Ekonomike në Duhel” dhe Planin Rregullues i Hollësishëm për “Zona Industriale në Shirokë”

Me datën 22.01.2025 Drejtoria për Urbanizëm, Planifikim dhe Mjedis në përbërje nga Drejtori i Drejtorisë (Menaxher i projektit) dhe koordinatori i projektit kanë organizuar takimin e parë me Ekipin Komunal për Planifikim të Planit Rregullues të Hollësishëm për “Zona Ekonomike në Duhel” dhe Planin Rregullues të Hollësishëm për “Zona Industriale në Shirokë” si dhe përfaqësuesit e operatorit ekonomik INSI (Instituti për Teknologji dhe Shkencë) ku u bë prezantimi i skenarëve, vizioni, qëllimet, objektivat strategjike për Planin Rregullues të Hollësishëm për Zonën Ekonomike në Duhel. Të pranishëm në takim kanë qenë edhe zyrtarët e Drejtorisë për Urbanizëm, Planifikim dhe Mjedis dhe kryetari i Komunës së Suharekës z.Bali Muharremaj.

Qëllimi i takimit të mbajtur kryesisht ishte prezantimi i tre draft skenarëve për Zonën Ekonomike në Duhël. Nga ekipi dhe nga zyrtarët e DUPM-së u tregua interesim i jashtëzakonshëm për këtë planë rregullues pasi që do të jetë qendra e dytë e Zhvillimit Ekonomik për vendin pas asaj të Zonës Industriale në Shirokë.

Kurse me 19 Mars Drejtoria për Urbanizëm, Planifikim dhe Mjedis me kërkesën e kryetarit të Komunës së Suharekës z.Bali Muharremaj dhe Drejtorit të Drejtorisë për Urbanizëm, Planifikim dhe Mjedis (Menaxher i projektit) kanë organizuar prezantimin e dytë publik rreth procesit të Planit Rregullues të Hollësishëm për “Zona Ekonomike në Duhël” dhe Planit Rregullues të Hollësishëm për “Zona Industriale në Shirokë” ku ishin të pranishëm përfaqësuesit e INSI-t, zyrtarët e DUPM-së, ekipi komunal i planifikimit të këtyre dy planeve dhe qytetarët e komunës së Suharekës.

Kryetari i Komunës së Suharekës, menaxheri i kontratës dhe përfaqësuesi i Insit kërkojnë nga qytetarët e pranishëm në takim, nga ekipi dhe nga zyrtarët e DUPM-së që të japin ide, të kërkojnë transparencë dhe të punojmë së bashku për të sjellë një të ardhme më të mirë.

Qëllimi kryesor i takimit ishte diskutim mbi hartimin, përmirësimin dhe zbatimin e planeve rregulluese në përputhje me kërkesat e qytetareve, kërkesat ligjore dhe zhvillimin e qëndrueshëm urban/rural. Temat e diskutuara në këtë prezantim ishin:

- **Gjendja aktuale** e planeve rregulluese ku u prezantua situata ekzistuese e dokumenteve rregulluese dhe sfidat në zbatim,
- **Propozime për përmirësim** ku u diskutuan ndryshimet e nevojshme në planet ekzistuese dhe nevoja për hartimin e planit të ri,
- **Përfshirja e paleve të interesit**, u theksua rëndësia e përfshirjes së komunitetit dhe institucioneve relevante në procesin e planifikimit,
- **Afatet dhe përgjegjësitë** ku u caktuan detyra konkrete për hartimin dhe finalizimin e planeve rregulluese.



Me kërkesën e menaxherit të projektit njëkohësisht drejtor i drejtorisë për Urbanizëm, Planifikim dhe Mjedis dhe koordinatores së projektit u mbajt puntoriae radhës me datë 27.05.2025 dhe takim pune me datë 03.06.2025 me Ekipin Komunal të Planifikimit për Planin Rregullues të Hollësishëm për “Zona Ekonomike në Duhël” dhe Planin Rregullues të Hollësishëm për “Zona Industriale në Shirokë” me zyrtarët e DUPM-së si dhe përfaqësuesit e operatorit ekonomik INSI (Instituti për Teknologji dhe Shkencë).

Ne këtë puntori u diskutua dhe u vendosen nga Ekipi Komunal i Planifikimit: Kufijtë e Zonës Ekonomike, Tipologjitë e përdorimit të tokës (industriale, komerciale, shërbime, etj), Parametrat urbanistik (vija ndërtimore, vija rregullative, lartësitë, distancat, hapësirat e gjelbërta etj.) dhe Infrastruktura kryesore (rrugë, ujësjellës, kanalizim, energji).

Poashtu u vendos që ky projekt plan të përgatitet për procedurat e shqyrtim publik.

4. Legalizimi i Objekteve pa Leje

Procesi i legalizimit në komunën tonë është prioritet institucional dhe po zbatohet me transparencë dhe në përputhje me aktet ligjore përkatëse.

Legalizimi i ndërtimeve pa leje përbën një nga sfidat dhe njëkohësisht prioritetet kryesore të Drejtorisë për Urbanizëm, Planifikim dhe Mjedis, duke pasur për qëllim rregullimin juridik dhe urbanistik të objekteve të ndërtuara pa leje. Ky proces synon integrimin e këtyre objekteve në sistemin formal të planifikimit urban, përmirësimin e menaxhimit të territorit dhe rritjen e sigurisë juridike për qytetarët.

Gjatë periudhës raportuese, komuna ka vijuar angazhimin për zbatimin e politikave të legalizimit në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe dokumentet e planifikimit hapësinor.

6.1 Baza Ligjore dhe Institucionale

Procesi i legalizimit në komunën tonë zhvillohet në përputhje me:

- legjislacionin në fuqi për planifikimin dhe zhvillimin e territorit,
- aktet nënligjore përkatëse,
- planet urbanistike dhe dokumentet strategjike lokale.

Drejtoria për Urbanizëm, Planifikim dhe Mjedis është institucioni përgjegjës për administrimin e këtij procesi, në bashkëpunim me drejtoritë dhe institucionet tjera relevante.

6.2 Gjendja Aktuale e Procesit të Legalizimit

Procesi i legalizimit në komunën tonë është në zhvillim të vazhdueshëm dhe përfshin trajtimin e një numri të konsiderueshëm kërkesash nga qytetarët. Fokus i veçantë i është kushtuar:

- verifikimit të dokumentacionit të paraqitur,
- kontrollit në terren të objekteve ekzistuese,
- vlerësimit të përputhshmërisë së objekteve me planet urbanistike.

Gjatë periudhës raportuese janë evidentuar raste të ndryshme, të cilat janë trajtuar në përputhje me kriteret ligjore dhe teknike.

- përmirësimin e planifikimit urban,
- rritjen e sigurisë juridike për pronarët e objekteve,
- formalizimin e ndërtimeve ekzistuese,
- rritjen e të ardhurave komunale përmes taksave dhe tarifave përkatëse.

Ky proces kontribuon gjithashtu në zhvillim më të qëndrueshëm dhe më të kontrolluar të territorit komunal.



Në përputhje me planin e bashkëpunimit institucional si memorandum i bashkëpunimit mes Komunës së Mamushës dhe Komunës tonë, me ftesë zyrtare për trajtimin dhe shqyrtimin e lëndëve të legalizimit në zyret e drejtorisë së Urbanizmit në Mamushë është zhvilluar takim pune për shqyrtimin e lëndëve të legalizimit, ku u diskutuan çështjet tekniko-

ligjore dhe u dakordësuan hapat e mëtejshëm të veprimit.

5. Sistemi i Unifikuar i Adresave

Në muajin shkurt për herë të parë në Komunën e Suharekës ka filluar vendosja e numrave zyrtarë në adresat tona, ku do të vendosen 20475 numra, për 1436 rrugë të regjistruara në Sistemin e Unifikuar të Adresave.



1. Punë të përgjithshme në bashkëpunim me institucionet dhe drejtoritë komunale të tjera

8.1 Raportim rreth PZHK-së, HZK-së dhe Digjitalizimi i tyre



Në prezencë të ekspertëve të planifikimit nga shtetet e BE-së – Holanda, Italia, Sllovakia dhe Kroacia – së bashku me Departamentin e Planifikimit, Institutin e Planifikimit nga MMPHI dhe disa nga komunat e Kosovës, drejtori i DUPM-së Visar Kuçi prezantoi Planin Zhvillimor Komunal (PZHK) dhe Hartën Zonale Komunale (HZK), si dhe digjitalizimin e tyre. Komuna jonë është e vetmja në Kosovë dhe rajon që ka digjitalizuar dhe i ka të publikuar online këto dokumente.

Gjithashtu, prezantoi përparësitë e këtyre dokumenteve dhe sfidat që po kalojmë si ne si

institucion. Ky takim u mbajt me 17 Mars.

8.2 Gjendja e lumenjëve në Komunën tonë

Takim me zyrtarët e autoritetit të rajonit të pellgjeve lumore (ARPL) në kuadër të MMPH-së ku u diskutua për gjendjen e lumenjëve në Komunën e Suharekës dhe masat që duhen ndërmarrë për menaxhimin e tyre të qëndrueshëm.



8.3 Hartimi i Planit Rregullues të Hollësishëm për fshatin Rekreativ – Turistik në Delloc

Fshati Rekreativ Turistik në Delloc është zonë e cila do të jetë unike në Kosovë, ku përfshin 750 hektarë, do të jetë një plan i detajuar ku synon të krijojë një bazë të fortë për zhvillimin e qëndrueshëm të fshatit Delloc, duke e shëndrruar atë në një destinacion tërheqës për vizitorët.

8.4 Memorandum bashkëpunimi mes Komunës së Suharekës dhe Odëssë Arkitektëve të Republikës së Kosovës

Ky memorandum ka për qëllim të vendosë bazat për bashkëpunim në fushën e planifikimit hapësiror, arkitekturës dhe zhvillimit urban të qëndrueshëm në Komunën e Suharekës, duke shfrytëzuar ekspertizën e OARK-së dhe vullnetit të Komunës së Suharekës për të siguruar zoatimin e praktikave më të mira në këto fusha:

- Hartimin e planeve strategjike, multidisiplinare e gjithpërfshires Komunale,
- Organizimin dhe zhvillimin e konkurseve profesionale për projektim arkitektonik dhe urban;
- Hartimi i kritereve profesionale për projektet dhe konkurset publike;
- Promovimin e transparencës, profesionalizmit dhe cilësisë në fushën e arkitekturës dhe urbanizmit në Komunën e Suharekës si dhe zbatimin e standardeve etike në proceset urbane;
- Ofrimit të asistencës dhe ekspertizës profesionale sipas nevojës.
- Zhvillimin e projekteve të përbashkëta që synojnë përmirësimin e infrastrukturës publike dhe cilësisë së jetesës në Komunën e Suharekës.

Si gjithmonë Komuna e Suharekës po avansohet me shërbime profesionale, për cilësi dhe zhvillim e zbatim të projekteve në të ardhmen

Drejtoria e Arsimit në Suharekë, përkundër sfidave të mëdha, në kuadër të kompetencave dhe përgjegjësi që ka, ka realizuar punë dhe detyra të shumta në funksion të ngritjes dhe përmirësimit të cilësisë në arsim dhe krijimit të kushteve më të mira në nivelin e arsimit parauniversitar, ku për vitin shkollor 2024/25, ka bërë një analizë dhe vlerësim të përgjithshëm mbi ecurinë dhe performancën e procesit edukativo-arsimor, duke e analizuar suksesin e nxënësve për rezultatet dhe sukseset e arritura në të tri nivelet e arsimit parauniversitar, duke krahasuar rezultatet e suksesit me rezultatet e periudhës së njëjtë të vitit paraprak.

Përfundimi i vitit shkollor 2024-2025 është bërë në kushte të rregullta. Ndërsa edhe viti i ri shkollor 2025-2026, ka filluar normalisht.

Drejtoria e Arsimit ka përcjellur nga afër ecurinë e procesit arsimor, duke i mbështetur shkollat me këshilla profesionale nga zyrtarët e arsimit, duke funksionalizuar dhe fuqizuar Aktivitetet profesionale (seksionet), duke bashkëpunuar me institucionet dhe organizata të ndryshme për zhvillimin profesional të mësimitdhënësve dhe sigurimin e efikasitetit të procesit të mësimitdhënies dhe mësimitnxënies dhe njëkohësisht në funksion të ngritjes dhe përmirësimit të cilësisë në arsim. Po ashtu, janë vlerësuar dhe analizuar rezultatet e testeve të jashtme të Provimit Shtetëror të Maturës si dhe Testi i Arritshmërisë për klasët IX-ta.

Duke ditur se vlerësimi është një proces dhe indikator determinues për nxjerrjen e treguesve kryesor, për ngritjen e cilësisë në arsim dhe për krijimin e një sistemi arsimor bashkëkohor në përputhje me kërkesat e shoqërisë së sotme-shoqërisë së dijes, kjo analizë bëhet jo vetëm për të konstatuar gjendjen, por edhe për të përcaktuar objektivat për të ardhmen, që do të reflektojnë pozitivisht në përmirësimin e shkallës së arritshmërisë së nxënësve dhe ngritjen e cilësisë së mësimitdhënies në procesin edukativo-arsimor.

Drejtoria e Arsimit po punon në mënyrë të vazhdueshme për krijimin e kushteve më të mira me qëllim që cilësia dhe rezultatet e suksesit në shkollat tona të shënoj progres dhe të arrijnë në nivelin dhe standardin e shkollave të përparuara, si në mësimitdhënie, mësimitnxënie dhe të një vlerësimi sa më objektiv të arritshmërisë së nxënësve.

Raporti i organizimit të punës së Drejtorisë së Arsimit

Drejtoria e Arsimit gjatë periudhës tremujore kishte për qëllim realizimin e objektivave të përcaktuara në planin vjetor të punës për vitin 2025 të cilat janë të mbështetura në objektivat kombëtare dhe strategjike të MASHTI si dhe objektivat komunale në PZHK të DKA-së të miratuar nga Asambleja Komunale të cilat janë shndërruara në detyra konkrete siç janë:

- Ngritja e cilësisë në mësimitdhënie dhe mësimitnxënie në të gjitha shkollat
- Ngritjen e suksesit të nxënësve dhe rritjen e nivelit të vijueshmërisë së nxënësve në procesin edukativo-arsimor.
- Realizimin e plan-programeve mësimore sipas fushave të KKK
- Plotësimin e kuadrit arsimor përmes konkurseve publike
- Vlerësimi i brendshëm i performancës së mësimitdhënësve
- Rilicencimi i mësimitdhënësve (ripertritja e licensës së karrierës)
- Vlerësimin e performancës së drejtorëve /zv.drejtorëve të shkollave .
- Menaxhimi i sigurisë në të gjitha nivelet e arsimit dhe në të gjitha institucionet edukativo-arsimore.
- Përgatitjet për organizimin e vlerësimeve të njohurive të nxënësve kombëtare : Testi i arritshmërisë – kl.9 dhe testi i maturës- kl.12 dhe vlerësimi ndërkombëtar PISA -2025 ,garave dhe aktiviteteve për nxënësit e të gjitha niveleve të shkollimit me qëllim të motivimit të nxënësve dhe mësimitdhënësve për ngritje të cilësisë në arsim.

- Rregullimin, pastrimin dhe mirëmbajtjen e ambientit të brendshme dhe të jashtëm të shkollave ruajtjen e shëndetit të nxënësve në të gjitha institucionet edukativo-arsimore të komunës sonë

Organizimi dhe menaxhimi i punës organizohet në

- 29 SHFMU me paralele të ndara ,
- Gjimnazin dhe 2 IAAP dhe
- institucioni parashkollor –çerdhja e fëmijëve “Flutura” me 7 (shtatë) paralele të ndara në Duhël, Mushtisht, Sopi, Gjinoç, Studenqan, Samadraxhë dhe Bukosh

Në këtë vit shkollor mësimi në një ndërrim organizohet në : 22 SHFMU si shkolla amë me paralele të ndara fizike , në gjimnazin “ Jeta e re” dhe IAAP { “Addyl Ramaj” në Shirokë

Numri i nxënësve në të gjitha nivelet e arsimit në komunën tonë

Planifikimi i numrit të nxënësve dhe paraleleve për vitin shkollor 2025/2026 është bërë në bashkëpunim me shkollat fillore dhe në mbështetje të UA nr. 03/2022 për regjistrimin e fëmijëve në institucione parashkollore dhe UA nr. 09 /2023-Regjistrimi i nxënësve në klasën e parë të MASHTI .Në bazë të këtij planifikimi janë regjistruar nxënësit në klasat e para dhe fëmijët në çerdhen “Flutura” Suharekë. Ndërsa planifikimi dhe regjistrimi i nxënësve në shkollat e mesme të larta është realizuar në bashkëpunim me MASHTI dhe SHML sipas kërkesave të tregut të punës në komunën tonë.

- ❖ Për vitin shkollor 2025/2026 numri i nxënësve është 8409 (duke përfshirë edhe çerdhen “Flutura” në Suharekë si dhe çerdhet private). Në krahasim me vitin shkollor 2024/25 numri i nxënësve është zvogëluar për 228 nxënës. Vlen të theksohet se zvogëlim të numrit të nxënësve ka në të gjitha shkollat rurale kurse rritje në ato urbane.

Numri i nxënësve në të gjitha nivelet e arsimit në Komunën e Suharekës

Nr.	Shkollat	Nxënës të regjistruar		
		F	M	Gjithsej
1	Qerdhe/Parafillor	183	188	371
	Qerdhe/private	83	93	176
2	Shkollat fillore dhe te mesme te ulta	2920	3216	6136
3	Gjimnazi“ JETA E RE”	284	166	450
4	IAAP “ Skënder Luarasi”	188	528	716
5	IAAP “ Abdyl Ramaj”	357	203	560
	Totali	4015	4394	8409


Suksesi i nxenesve në fund të vitit shkollor 2024/2025

Sipas raporteve të shkollave dhe të dhënave të paraqitura në sistemin SMIA të MASHTI suksesi dhe vijueshmëria e nxënësve është i kënaqshëm . Në vazhdim e paraqesim suksesin e nxënësve dhe mungesat në fund të vitit shkollor 2024/2025

Nr	Niveli Arsimor	Shkëlq.	Sh.mire	Mirë	Mjaf.	Me një e më shumë nota të dobëta	Të pa notuar	Gjithsej
1	Arsimi Fillor	2508	1192	1180	681	281	91	5933
2	Arsimi i mesëm	433	443	560	260	38	19	1753
Gjithsej		2941	1635	1740	916	319	110	7686

- Suksesi i paraqitur në formë skematike

**Suksesi i nxënësve në fund të vitit shkollor
2025/2026**



- Krahësuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar nuk kemi ngritje të suksesit
- **Kuadri :** Në bazë të të dhënave të SMIA të muajit nëntor 2025 në arsimin parafillor, fillor, mesëm të ulët dhe të mesëm të lartë janë të angazhuar 1000 punëtorë, shih tab.

Nr	Programi arsimor	Personeli			Gjithsej personeli 2025/2026
		Mësimdhënës	Personeli administrativ	Personeli mirembajtes	
1	Çerdhja “Flutura” Suhareke	34	2	12	48
2	Shkolla fillore, e mesme e ulët	617	47	91	755
3	Shkolla e mesme e lartë	166	7	24	197
	Gjithsej	817	56	127	1000

Vlerësimi i jashtëm i njohurive të nxënësve

(Vlerësimi PISA, Testi i arritshmërisë-kl. 9, Testi i maturës-12,

Drejtoria Komunale e Arsimit në bashkëpunim me MASHTI janë në proces të realizimit të vlerësimeve të njohurive të nxënësve dhe i kanë bërë të gjitha përgatitjet për organizimin e vlerësimeve të jashtme të njohurive të nxënësve dhe të vlerësimit të brendshëm të njohurive të nxënësve :

➤ **Vlerësimet e jashtme në nivel vendi :**

- Testi i arritshmërisë – kl.9 dhe
- Testi i maturës- kl.12

➤ **Vlerësimeve ndërkombëtare :**

- Vlerësimi PISA

Testi “PISA 2025” -Bazuar në kërkesat e MASHTI-t, Drejtoria e Arsimit ka bërë të gjitha përgatitjet për realizimin e e projektit “ PISA 2025” për të gjithë nxënësit 15 vjeçar të të gjitha shkollave të mesme të ulëta dhe të mesme të larta të komunës sonë. Kriteret për përfshirje të nxënësve në PISA kanë qenë: nxënësit e lindur nga 01.01.2009 dhe 31.12.2009. Nga gjithsej nx. 15 vjeçar të komunës sonë janë përzgjedhur 219 nxënës për t’iu nënshtruar këtij testi. Testimi “ PISA 2025” i cili është realizuar në muajin maj dhe janë përfshirë tri shkollat e mesme të larta : Gjimnazi ” Jeta e re “, SHP” Abdyl Ramaj”- Shirokë dhe SHMT “ Skender Luarasi ” si dhe katër SHFMU “ Dëshmorët e Kombit”-Vraniq, SHFMU “ Naum Veqilharxhi”- Mohlan, SHFMU ”Drita”-Gelancë dhe SHFMU “Xhavit Sylaj”-Sllapuzhan.

Matura 2025 - Bazuar në Ligjin mbi Maturën Shtetërore Nr. 05/L-018 , UA 05/2016 -Detyrat dhe përgjegjësitë e administruesëve dhe komisionëve të qendrave të testimit dhe Vendimit të Ministrit të Arsimit, Shkencës dhe Inovacionit (MASHTI) nr. 01/008 të datës 25.02.2025 janë ndërmarr të gjitha masat që të realizohet ky proces. Shkollat dhe DKA janë angazhuar rrethte gjitha përgatitjeve për organizimin e testit të maturës 2025. Aplikimi për paraqitjen e testit është bërë përmes platformës E-Kosova

Bazuar në të dhënat e shkollave, 564 maturantë e kane paraqitë Provimin e maturës përmes platformës E- Kosova dhe iu nënshtruan Provimit të Maturës shtetërore në vitin shkollor 2024/2025,

Testi i arritshmërisë-kl. 9 -Komuna e Suharekës do të organizoi Testin e arritshmërisë për klasat e IX-ta sipas planifikimeve të MASHTI-it, DKA dhe shkollat janë duke i bërë të gjitha përgatitjet e nevojshme për mbarrëvajtje e këtij procesi. Bazuar në të dhënat e shkollave 654 nxënës iu nënshtruan testit të arritshmërisë me datë 27.06.2025. Testi u realizua në 3 objekte shkollore përkatësisht në 5 qendra të testimit.

Vizitat e realizuara në shkolla

DKA me qëllim të avancimit të punës në institucionet shkollore ka planifikuar vizitat e rregullta dhe vizita speciale në shkolla për kontrollimin e mbarrëvajtjes së procesit edukativo-arsimor, mirëmbajtja e dokumentacionit pedagogjik-administrativ mirëmbajtja e ambientit të brendshëm dhe të jashtëm dhe sigurinë shkolla:

Për të gjitha shkollat fillore të mesme të ulëta dhe të mesme të larta janë hartuar Procesverbalet e incizimit të gjendjes së bashku me rekomandimet për të eliminuara lëshimet e konstatuara.

Vlerësimi i performancës së drejtorëve /zëvendës drejtorëve të shkollave

Në bazë të UA-106/2020, DKA e ka formuar komisionin për vlerësim të performancës së drejtorëve dhe zëvendës drejtorëve të shkollave për periudhën e punës katërvjeçare. Komisioni prioritet për vlerësim të performancës së drejtorëve dhe zëvendës drejtorët të cilëve iu përfundonte mandati(kontrata e punës) , e që në këtë periudhë është vlerësuar performanca e drejtorit të SHFMU-ve:

1. SHFMU "Shkëndija" në Suharekë
2. SHFMU "Hasan Prishtina"-Semetisht,
3. SHFMU "Kongresi I Manastirit"-Studençan,
4. SHFMU "Shaban Mazreku"-Sopijë,
5. IAAP "Abdyl Ramaj"-Shirokë,
6. SHFMU "Drita" Gelancë,
7. SHFMU "Naum Veqilharxhi"-Mohlan,
8. SHFMU "Vëllezërit Frashëri"-Bukosh,
9. SHFMU "Dëshmorët e Greikocit"-Greikoc

Vlerësimi i brendshëm i performancës së mësimitdhënësve

Me vendim të MASHTI nr.01b/041, datë 29.04.2024 është miratuar udhëzuesi për vlerësim të performancës së mësimitdhënësve për ripertritjen e licencës së karrierës i cili bazohet në:

1. Kornizën strategjike për zhvillimin e mësimitdhënies në Kosovë
 2. Ua nr. 14/2023 të MASHTI –për sistemin e licensimit dhe karrierën në mësimitdhënie
 3. Ua nr. 15 /2023 të MASHTI –për vlerësimin e performancës së mësimitdhënësve
- Sistemi i vlerësimit të performancës së mësimitdhënësve përbëhet nga vlerësimi i brendshëm dhe vlerësimi i jashtëm

Vlerësimi i brendshëm i referohet procesit të:

- Vetëvlerësimit,
- Vlerësimit nga mësimitdhënësit,
- Vlerësimit nga drejtori i shkollës, dhe
- Vlerësimi nga nxënësit.
- Procesi i vpm të brendshëm, bazohet në kapacitetet e shkollës me besimin dhe bindjen se shkollat tashmë kanë udhëheqje të përgjegjshme dhe profesionale për administrim të këtij procesi, si dhe mësimitdhënësit kanë kapacitetet e nevojshme për realizimin e tij. Drejtori është përgjegjës të udhëheqë dhe të administrojë tërë procesin e vpm të brendshme për secilin mësimitdhënë të shkollës.

Për realizimin e këtij procesi DKA i ka përgatitur të gjitha informatat dhe udhëzuesit për mbarrëvajtje vlerësimit të performancës së mësimitdhënësve.

Licencimi i mësimitdhënësve dhe zhvillimi profesional i mësimitdhënësve

Nga informatat e shkollave rezulton se deri më tani e kanë ripërtërirë licencën një numër i

konsiderueshëm i mësimdhënësve dhe procesi po vazhdon me sukses.

Bursat për nxënës dhe studentë në vitin shkollor 2024/2025

Drejtoria Komunale e Arsimit me autorizimin e kryetarit të komunës ka shpallur konkursin për ndarjen e bursave për vitin shkollor 2024/2025, me nr. 05-nr.016-2813

Konkursi është shpallur në bazë të vendimit të Kryetarit të Komunës 01 nr.104-70025 të datës 26.12.2024.

Në bazë të vendimit për ndryshim–plotësimin 014r. 410-7438 me date 30.01.2025 dhe vendimit 01-nr.016- 6358, të dt. 28.01. 2022 të Asamblesë komunale është formuar komisioni për shqyrtimin e aplikacioneve për ndarjen e bursave për studentë/e dhe nxënës/e të Komunës së Suharekës.

Në këtë konkurs kanë aplikuar 383 nxënës (F-259 M-124) dhe 358 studentë (F-278 M- 80).

Komisioni duke u bazuar në Rregulloren për ndarjen e bursave, ka ndarë 240 bursa për studentë (F-189 M-51)dhe 110 bursa për nxënës (F-278 M-80) për vitin shkollor 2024/2025. Vlen të theksohet se Komisioni për shqyrtimin e kërkesave për bursa për nxënës dhe studentë në mënyrë decitive ka respektuar Rregulloren për ndarjen e bursave për vitin shkollor

Garat, aktivitetet e lira dhe aktivitetet jashtëmësimore në periudhën janar – dhjetor 2025

- **Garat në fushën e fizikës:** Në fillimin e vitit të ri kalendarik 2025 kemi startuar me realizimin e garave komunale në fushën e fizikes në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit dhe Shoqaten e fizicientëve të rinj , ku katër vendet e para kane përfaqësuar komunën tonë në garat në nivel republikan

- Raport i garave të matematikës në nivel komunal dhe republikan

- **Garat e matematikës :**Në muajin mars në objektin e IAAP "Abdyl Ramaj" – Suharekë, u mbajt me sukses Gara Ndërkombëtare e Matematikës “Kangaroo Kosova 2025” për regionin e Prizrenit. Me pjesëmarrjen e nxënësve të talentuar dhe mbështetjen e Komunës së Suharekës, Institutit ATOMI, MASHT dhe shkollave pjesëmarrëse, kjo garë u zhvillua në një atmosferë inspiruese për të gjithë dashamirësit e matematikës. Nga Suhareka pjesëmarrëse ishin nxënësit nga klasa e parë deri në të nëntën nga SHFMU “Destan Bajraktari” Suharekë ,SHFMU “7 Marsi” Suharekë dhe SHFMU “28 Nëntori” Dobërdelan,SHFMU” Lidhja e Prizrenit” Budakovë,SHFMU “ Kongresi Manastirit” Studenqan,SHFMU” Shkëndija “Suharekë, SHFMU “Edit Durham “Mushtish, SHFMU”V. P. Shkodrani” Leshan, SHFMU “17 Shkurti” Shirokë dhe SHFMU “Ramë Bllaca” Bllacë

- **Pi Day në Suharekë;** Suhareka festoi Ditën e Matematikës me një aktivitet të jashtëzakonshëm, ku **kreativiteti**

dhe logjika u bashkuan për të frymëzuar brezat e rinj!**Nxënësit nga shkollat e komunës sonë** prezantuan **projekte inovative** para mësimdhënësve, mysafirëve të nderuar dhe **profesorëve nga SHBA dhe Gjermania**, duke treguar se **matematika nuk është thjesht numra – është një gjuhë universale e zbulimit dhe**

inovacionit! Pjesë e kësaj dite të veçantë ishte edhe Koncerti Duo nga artistet: Ledian Shala dhe Agron Shujaku, të cilët e bënë atmosferën edhe më magjike. Ky aktivitet u realizua falë bashkëpunimit të **Drejtorisë së Arsimit, Shtëpisë së Fellbahut, Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit** si dhe përkushtimit të **mësimdhënësve të matematikës**, të cilët inkurajojnë çdo ditë **mendimin kritik dhe kreativ!**

Garat e gjuhës shqipe në nivel komunal dhe republikan

Në mbështetje të Memorandumit të Mirëkuptimit mes Ministrisë së Arsimit dhe Sportit të Republikës së Shqipërisë dhe Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit të Republikës së Kosovës dhe vendimit të përbashkët për realizimin e Olimpiadës së përbashkët të gjuhës shqipe për klasën e 9-të, për vitin shkollor 2024-2025 (Kosovë – Shqipëri), në komunën Suharekës u realizua testi i Olimpiadës së përbashkët të gjuhës shqipe për klasën e 9-të” në nivel shkolle ku morën pjesë 413 nxënës dhe më pas u realizua testimi në nivel komunal ku gjithsej 84 nxënës të cilët kaluan fazën e parë janë përfshirë në testim. Lidhur me këtë aktivitet nga DKA janë formuar komisione për hartimin e dhe vlerësimin e testeve dhe besojmë në realizimin me suksese të kësaj olimpiade edhe në fazat në vijim. Nxënësit fitues nga kjo garë do të jenë pjesë e garës në nivel republikan dhe pas rezultateve të garës komunale, nxënësit fitues të cilët kaluan 65% e totalit të pikëve, do të përfaqësojnë komunën tone në garat Republikane ku të zgjedhurit nga gara republikane do të përfaqësojnë Republikën e Kosovës në garat mes dy shteteve Kosovë-Shqipëri.

Lista e nxënësve për Olimpiadën e Gjuhës Shqipe, faza e tretë (niveli republikan)

Lista e nxënësve për Olimpiadën e Gjuhës shqipe, faza e tretë (niveli republikan)						
1	“RamëBllaca” - Bllacë	Elsa	Afrim	Pirku	37	74%
2	Dëshmorët e Kombit-Vraniq	Eliona	Betim	Basha	36.5	73%
3	Shkëndija- Suharekë	Learta	Shukri	Tërshani	36	72%
4	Shkëndija-Suharekë	Diona	Rrahman	Ramaj	35.5	71%
5	DestanBajraktari-Suharekë	Era	Astrit	Gashi	35	70%
6	DestanBajraktari-Suharekë	Era	Safet	Guri	34	68%
7	DestanBajraktari-Suharekë	Veron	Fatmir	Gashi	33.5	67%
8	28 Nëntori-Doberdelan	Dren	Bajram	Balaj	32.5	65%

Garat e Olimpiades se matematikes në nivelshkolle dhe komune

Olimpiada Komunale e Matematikës në Suharekë u mbajt më 13 dhjetor 2025 dhe përfshiu pjesëmarrjen e 73 nxënësve nga klasa 7-të deri në klasën 12-të. Procesi i organizimit dhe realizimit në komunën e Suharekës u krye me sukses. Nxënësit treguan një nivel të lartë përgatitjeje dhe konkurrimi..

Nxënësit që do të përfaqsojnë komunën e Suharekës sipas rezultateve të treguara janë parqitur në tabelën e renditjeve si më poshtë:

Klasa: VII-të

Nr.	Emri dhe mbimeri nxënësit	Shkolla (SHFMU)	Vendi	Komuna	Pikët
1	Dunit Bytyqi	Krongresi I Manastirit	Studenqan	Suharekë	54
2	Enea Selimi	Edit Durham	Mushtisht	Suharekë	44

Klasa: VIII-të

Nr.	Emri dhe mbiemri nxënësit	Shkolla	Vendi	Komuna	Pikët
1	Alea Hoxha	Destan Bajraktari	Suharekë	Suharekë	36
2	Denisa Llugaxhiu	Dëshmorët e Kombit	Vraniq	Suharekë	30

Klasa: IX-të

Nr.	Emri dhe mbiemri nxënësit	Shkolla (SHFMU)	Vendi	Komuna	Pikët
1	Diona Buqaj	Naum Veqilhargji	Mohlan	Suharekë	28
2	Sinera Zenelaj	Migjeni	Gjinoc	Suharekë	24

Klasa: X-të

Nr.	Emri dhe mbiemri nxënësit	Shkolla	Vendi	Komuna	Pikët
1	Altin Krasniqi	IAAP "Skënder Luarasi"	Suharekë	Suharekë	24
2	Lorena Bytyqi	IAAP "Skënder Luarasi"	Suharekë	Suharekë	24
3	Nina Berisha	Gjimnazi "Jeta e Re"	Suharekë	Suharekë	22

Klasa: XI-të

Nr.	Emri dhe mbimeri nxënësit	Shkolla	Vendi	Komuna	Pikët
1	Drion Kafexholli	Gjimnazi "Jeta e Re"	Suharekë	Suharekë	48
2	Erleta Lumi	Gjimnazi "Jeta e Re"	Suharekë	Suharekë	24
3	Jon Basha	Gjimnazi "Jeta e Re"	Suharekë	Suharekë	24

Klasa: XII-të

Nr.	Emri dhe mbiemri nxënësit	Shkolla	Vendi	Komuna	Pikët
1	Adea Kuçi	Gjimnazi "Jeta e Re"	Suharekë	Suharekë	38
2	Rinesa Abdullahu	Gjimnazi "Jeta e Re"	Suharekë	Suharekë	28

Siguria në shkolla

Drejtoria Komunale e Arsimit i ka marr të gjitha masat për krijimin e një klime sa më të mirë në të gjitha institucionet shkollore duke pasur parasysh që nxënësit një pjesë shumë të madhe të kohës e kalojnë në ambientet shkollore dhe është shumë e rëndësishme jo vetëm për mirëqenien e tyre po edhe për vetë procesin edukativo-arsimor, të ketë siguri të lartë në shkollë.

Konkurset

✓ Janë pranuar përmes intranetit gjithësejt **1,607** lëndë prej tyre të miratuara **905**,refuzuara **683**,në proces **19**.

Gjatë kësaj periudhe janë shpallur gjithësejt 27 konkurse prej tyre:

- Dy konkurse per drejtor shkolle- Drejtor në SHFMU Xhavit Sylaj” në Sllapuzhan i cili është anuluar në munges të kandidatëve të kualifikuar dhe konkursi për drejtor në SHFMU”Dituria”Samadaraxhë i cili është ende në procedure.
- Dy konkurs për asistent për FNV të cilët janë anulluar pasi që nuk ka pasur kandidate të kualifikuar,
- Dy konkurse per sekretar shkolle .
- Katër konkurse për punëtor teknik-mirëmbajtës të cilat janë përfunduar me sukses.
- Një konkurs për psikolog (është në procedure)
- 16 konkurse për mësimdhënës(vende të lira dhe zëvendësime).

Pensionime: gjatë kësaj periudhe janë pensionuar gjithësejt tridhjetetë (33) punëtor

Pushime të lehonisë Në pushim të lehonisë janë tridhjetegjashtë (36) punëtorë.

Buxheti /Financat

- Hartimi i buxhet të DKA-së dhe shkollave për vitin 2026 dhe parashikimi për vitin 2027, 2028. Hartimi i buxhetit sipas qarkores buxhetore 2026/01 duket si në tabelë:

Përshkrimi	Buxheti Aktual	Alokuar	E paalokuar	Aktuali	Zotimet/obli gimet e papaguara	Bilanci	Suficit/Deficit
CAT / RESP	A	B	A - B	C	D	A-(C+D)	A - E
10 BUXHETI	10,691,384.10	9,927,649.16	763,734.94	9,843,797.33	83,342.72	764,244.05	10,691,384.10
